<p>1.35. Abuzimi seksual i fëmijës - nënkupton shprehjen e abuzimit brenda shtëpisë ose familjes, por nuk përjashton edhe rastet e abuzimit nga persona jashtë familjes duke përdorur përparësitë e pozitës qoftë sociale apo edhe zyrtare për përfitime seksuale nga viktima e abuzimit. Aktiviteti seksual i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër;</p> <p>1.36. Institucion – nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës në këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.37. Sistemi për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar dhunën, abuzimin, neglizhimin dhe shfrytëzimin e fëmijës. Sipas kuptimit të</p>	<p>1.35. Child sexual abuse - shall mean the expression of abuse within the home or the family, but does not exclude cases of abuse by persons outside the family by taking advantage of either social or official position for sexual benefit from the victim of abuse. Sexual activity which implies sexual intercourse and any other form performed by, with, and before the child, where the presence or the participation of the child is for the purpose of sexual satisfaction of the other person;</p> <p>1.36. Institution – shall mean all public, central and local institutions, as well as other private legal persons in the Republic of Kosovo, who have the responsibility for the child protection under this Law and the legislation in force;</p> <p>1.37. Child Protection System - shall mean the specific formal and non-formal structure with general and unified functions and capacities to prevent and respond to violence, abuse, negligence and exploitation of the child. In general terms, the child protection system consists of the</p>	<p>1.35. Seksualno zlostavljanje deteta - podrazumeva izražavanje zlostavljanja unutar kuće ili porodice, ali ne isključuje slučajeve zlostavljanja od strane lica van porodice korišćenjem prednosti bilo socijalne ili službene pozicije za seksualne koristi od žrtve zlostavljanja. Seksualna aktivnost koja podrazumeva seksualni odnos i bilo koji drugi oblik koji obavljen od strane, sa i pred detetom, gde je prisustvo ili učešće deteta u svrhu seksualnog zadovoljstva drugog lica;</p> <p>1.36. Institucija –podrazumeva sve javne, centralne i lokalne institucije, kao i druga privatna pravna lica u Republici Kosovo, koja su odgovorna za zaštitu deteta u ovom Zakonu i važećem zakonodavstvu;</p> <p>1.37. Sistem za zaštitu deteta - podrazumeva određenu formalnu i neformalnu strukturu sa sažetim i udruženim funkcijama i kapacitetima za sprečavanje i reagovanje na nasilje, zlostavljanje, zanemarivanje i iskorišćavanje deteta. U opštem smislu, sistem zaštite deteta sastoji se</p>
--	---	---

<p>përgjithshëm, sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet nga këto komponente: resurset njerëzore dhe financiare, ligjet dhe politikat, qeverisja, monitorimi dhe mbedhja e të dhënave, shërbimet mbrojtëse dhe reaguese, si dhe menaxhimi i rastit. Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë: fëmijët, familja, komuniteti, shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përfshirë ata në nivel ndërkombëtar. Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komponentëve dhe akterëve brenda këtij sistemi;</p> <p>1.38. Komiteti - nënkupton Komitetin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>1.39. Këshilli - nënkupton Këshillin për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>1.40. Ekipi – nënkupton Ekipin për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>1.41. Tryeza Multidisiplinare për Ndhmë në Menaxhimin e Rastit - nënkupton grupin multidisiplinar, që përfshinë profesionistët nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterët e tjerë që</p>	<p>following components: human and financial resources, laws and policies, governance, monitoring and data collection, protection and response services, and case management. The system also includes different stakeholders such as children, the family, the community, the civil servants and officials of the central and local level, not excluding those working at international level. The functioning of the system depends on the interaction and the relationships between the components and stakeholders within this system;</p> <p>1.38. Committee - shall mean the Inter-Ministerial Committee on the Rights of the Child;</p> <p>1.39. Council - shall mean the Council on the Rights of the Child;</p> <p>1.40. Team – shall mean the Team on the Rights of the Child;</p> <p>1.41. Multidisciplinary Roundtable for Assistance in Case Management - shall mean a multidisciplinary group that includes professionals from relevant child protection institutions and other stakeholders representing a</p>	<p>od ovih komponenti: ljudskih i finansijskih resursa, zakona i politika, upravljanja, praćenja i prikupljanja podataka, usluga zaštite i reagovanja kao i upravljanja predmetima. Sistem takođe uključuje različite aktere kao što su deca, porodica, zajednica, službenici i zvaničnici centralnog i lokalnog nivoa, ne isključujući i one na međunarodnom nivou. Funkcionisanje sistema zavisi od interakcije i odnosa između komponenti i aktera unutar ovog sistema;</p> <p>1.38. Odbor - podrazumeva Međuministarski odbor za Prava deteta;</p> <p>1.39. Savet - podrazumeva Međuministarski savet za Prava deteta;</p> <p>1.40. Tim – podrazumeva tim za Prava deteta;</p> <p>1.41. Multidisiplinarni okrugli sto za pomoć u upravljanju slučajevima - podrazumeva multidisiplinarnu grupu koja obuhvata stručnjake iz odgovarajućih institucija za zaštitu deteta i druge aktere koji zastupaju</p>
--	---	--

<p>përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;</p> <p>1.42. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë - nënkupton Zyrën përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;</p> <p>1.43. Menaxheri i rastit - nënkupton zyrtarin përgjegjës të caktuar nga Organi i Kujdestarisë, për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili në bashkëpunim me akterët relevantë vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes;</p> <p>1.44. Qendra për Punë Sociale (QPS) - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetentë edhe për mbrojtjen e fëmijës në nevojë;</p> <p>1.45. Organi i kujdestarisë - nënkupton organin përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë</p>	<p>variety of disciplines, who are responsible for child protection, interact and coordinate their efforts to address specific cases of child abuse, child ill-treatment and neglect based on the best interests of the child;</p> <p>1.42. Relevant Unit for Good Governance - shall mean the Office for Good Governance within the Office of the Prime Minister;</p> <p>1.43. Case manager – shall mean the responsible officer, appointed by the Guardian Body, for case management of a child, who, in cooperation with relevant stakeholders, assesses needs of the child and drafts care plans;</p> <p>1.44. Centre for Social Work (CSW) - shall mean the public professional institution at municipal level, competent for protection of the child in need;</p> <p>1.45. Guardian Body – shall mean the body responsible for child protection, which acts within the Centre for Social</p>	<p>raznovrsnost disciplina, koji su odgovorni za zaštitu deteta, i koji međusobno deluju i koordiniraju njihova nastojanja za tretiranje specifičnih slučajeva, zlostavljanja, maltretiranja i zanemarivanja dece, na osnovu najboljeg interesa deteta;</p> <p>1.42. Odgovarajuća jedinica za dobro upravljanje - podrazumeva odgovarajuću Kancelariju za dobro upravljanje u okviru kabineta premijera;</p> <p>1.43. Rukovodilac slučaja - podrazumeva odgovornog službenika kojeg imenuje Organ starateljstva, za upravljanje slučajem deteta koji u saradnji sa relevantnim akterima procenjuje potrebe deteta i izrađuje plan staranja;</p> <p>1.44. Centar za socijalni rad (CSR) - podrazumeva profesionalnu javnu instituciju na opštinskom nivou, nadležnu i za zaštitu deteta u nevolji;</p> <p>1.45. Organ starateljstva - podrazumeva odgovorno telo koje deluje u okviru Centra za socijalni rad</p>
--	--	--

<p>Sociale përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.46. Zyrtar i Shërbimeve Sociale - nënkupton profesionistin e shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin e Këshillit të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare.</p> <p>KAPITULLI II - PARIMET E MBROJTJES SË FËMIJËS</p> <p>Neni 4 E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim</p> <p>1. Mbrojta e jetës së fëmijës është detyrimi kryesor për çdo person, institucion apo organ tjetër.</p> <p>2. E drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, që do të thotë e drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.</p>	<p>Work;</p> <p>1. 46. Social Service Official - shall mean the social and family service professional with adequate qualifications in the field of social work, psychology, sociology, justice, pedagogy or any other field closely related to social and family services, who is licensed and registered in the register of General council for social and family services;</p> <p>CHAPTER II - CHILD PROTECTION PRINCIPLES</p> <p>Article 4 Right to life, survival and development</p> <p>1. Protection of life of the child should be the main obligation for every person, institution or other body.</p> <p>2. The child's right to survival and development, which means the child's right to physical, mental, emotional, educational, health, social development and well-being, must be protected to the maximum extent possible by any person, institution or any other body.</p>	<p>nadležnog za zaštitu deteta;</p> <p>1.46. Službenik za socijalne usluge - podrazumeva stručnjaka za socijalne i porodične usluge sa odgovarajućim kvalifikacijama u oblasti socijalnog rada, psihologije, sociologije, pravde, pedagogije ili neke druge oblasti koja je blisko povezana sa socijalnim i porodičnim uslugama koje je licencirano i registrovano u Registru Generalni savet za socijalne i porodične usluge;</p> <p>POGLAVLJE II - PRINCIPI ZAŠTITE DETETA</p> <p>Član 4 Pravo na život, opstanak i razvoj</p> <p>1. Zaštita života deteta je glavna obaveza svake osobe, institucije ili drugog organa.</p> <p>2. Pravo deteta na opstanak i razvoj, tj. pravo deteta na fizički, mentalni, emocionalni, vaspitni, zdravstveni, socijalni razvoj kao i blagostanje deteta, moraju biti zaštićeni u najvećoj mogućoj meri od strane svakog lica, institucije ili drugog organa.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 5 Interesi më i mirë i fëmijës</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Best interest of the child</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Najbolji interes deteta</p>
<p>1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.</p> <p>2. Ky Ligj, si dhe aktet e tjera juridike që rregullojnë çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të mirë të fëmijës.</p> <p>3. Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës.</p> <p>4. Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim:</p>	<p>1. The best interest of the child shall prevail and have the highest consideration regarding all child-related actions and decisions that are taken by parents or guardians, institutions, child protection services, child protection professionals, courts, administrative authorities or legislative bodies.</p> <p>2. This law, and other legal acts that regulate the matters relating to child protection, as well as any other individual act based on them, is subject to the principle of the best interest of the child.</p> <p>3. The best interest of the child requires a comprehensive effort to ensure the child's physical, psychological, moral and spiritual integrity and promotion of human dignity, by taking into account the individual characteristics and the child's social condition.</p> <p>4. In order to ensure the best interest of the child, the following principles should be observed:</p>	<p>1. U svim radnjama i odlukama koja se tiču deteta, preduzetih od strane roditelja ili staratelja, institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalca za zaštitu deteta, sudova, upravnih vlasti ili zakonodavnih organa, najbolji interes deteta treba da bude prevladavajuća i najviša obaveza.</p> <p>2. Ovaj zakon, kao i drugi pravni akti koji regulišu pitanja koja se odnose na zaštitu deteta, kao i bilo koji drugi pojedinačni akt, koji proizilazi od njih, podleže principu najboljeg interesa deteta.</p> <p>3. Najbolji interes deteta zahteva sveobuhvatan napor kako bi se obezbedio fizički, psihički, moralni i duhovni integritet deteta i promovisao ljudsko dostojanstvo, uzimajući u obzir individualne karakteristike i socijalno stanje deteta.</p> <p>4. Da bi se obezbedio najbolji interes deteta, treba poštovati sledeće principe:</p>

<p>4.1. familja është përgjegjëse kryesore për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur fëmijët; institucionet ndihmojnë familjet me këtë detyrim dhe ndërhyjnë vetëm kur familja nuk është në gjendje, apo nuk është e aftë ose ka nevojë për ndihmë për të mbrojtur fëmijën;</p> <p>4.2. qëndrueshmëria duhet të jetë qëllim kyç, duke zgjedhur intervenimin sa më të pakët në jetën e fëmijës për të siguruar stabilitetin e marrëdhënieve personale të fëmijës dhe të shoqërisë, mjedisit dhe për të garantuar vazhdimësinë e arsimimit, trajnimit të fëmijës, ose punësimit;</p> <p>4.3. Vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme;</p> <p>4.4. prindërit, kujdestarët dhe fëmija marrin pjesë në të gjitha fazat e procedurës përveç nëse është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës;</p> <p>4.5. mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;</p>	<p>4.1. The family is primarily responsible for caring for and protecting the children; institutions help families with this obligation and intervenes only when the family is unable or incapable or needs help to protect the child;</p> <p>4.2. Sustainability should be a key goal, by choosing the intervention that least interferes with the child's life to ensure the stability of the child's personal relation with society, environment and guarantee the continuity of child education, training or employment;</p> <p>4.3. Administrative and judicial decisions affecting the child must be taken and enforced promptly and without unreasonable delays;</p> <p>4.4. Parents, guardians and the child shall take part in all stages of the procedure unless it is in contradiction with the child's best interest;</p> <p>4.5. Views of the child depending on age and maturity of the child to comprehend the situation;</p>	<p>4.1. Porodica je glavna odgovorna za staranje i zaštitu dece; Institucije pomažu porodicama za ovu obavezu i intervenišu samo kada porodica nije sposobna ili ima potrebu za pomoć u zaštiti deteta;</p> <p>4.2. održivost treba da bude ključni cilj, odabirajući što manju intervenciju u životu deteta kako bi se osigurala stabilnost ličnih i odnosa deteta i društva, okruženja i garantovanje kontinuiteta obrazovanja, obuke deteta ili zapošljavanja;</p> <p>4.3. Administrativne i sudske odluke koje utiču na dete moraju da se donesu i sprovedene brzo i bez nerazumnih odlaganja;</p> <p>4.4. Roditelji, staratelji i dete učestvuju u svim fazama postupka, osim ukoliko nije u sukobu sa najboljim interesom deteta;</p> <p>4.5. mišljenje deteta, zavisno od njegovog uzrasta i sposobnosti da razume;</p>
--	--	--

<p>4.6. historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;</p> <p>4.7. vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore/farefisnore, shoqërore dhe/ose shpirtërore, dhe të gjitha vendimet dhe iniciativat që janë objekt i këtij Ligji, duhet të marrin parasysh individualitetin, moshën dhe pjekurinë, gjuhën amtare, seksin, gjininë, identitetin, gjendjen shëndetësore dhe aftësitë e veçanta të fëmijës me qëllim të ruajtjes së identitetit etnik, racor, fetar dhe kulturor të fëmijës, sipas rrethanave.</p> <p>5. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa.</p>	<p>4.6. Background of the child considering special situations of abuse, negligence, exploitation or other forms of violence against the child and the potential risk of occurrence of similar situations in the future;</p> <p>4.7. Continuity of personal relations between the child and persons with whom they have kinship, social and/or spiritual relations, and all decisions and initiatives that are subject of this Law, should consider the individuality, age and maturity, mother tongue, sex, gender, identity, health condition and special abilities of the child in order to preserve ethnic, racial, religious and cultural identity of the child, in line with the circumstances.</p> <p>5. Interpretation of the child's best interests should be in full compliance with the Convention on the Rights of the Child and no supposed interpretation of what is in the best interest of the child can justify the violation of any right recognized by the Convention.</p>	<p>4.6. istorijat deteta, uzimajući u obzir specifične situacije zlostavljanja, zanemarivanja, iskorišćavanja ili drugih oblika nasilja nad detetom i potencijalnog rizika da će se slične situacije dogoditi u budućnosti;</p> <p>4.7. kontinuitet ličnih odnosa između deteta i lica sa kojim ima rodne/srodne, društvene i/ili duhovne odnose i sve odluke i inicijative koje su predmet ovog Zakona moraju uzeti u obzir individualnost, starost i zrelost, maternji jezik, pol, rod, identitet, zdravstveno stanje i posebne sposobnosti deteta u cilju očuvanja etničkog, rasnog, verskog i kulturnog identiteta deteta, prema okolnostima.</p> <p>5. Tumačenje najboljeg interesa deteta treba da bude u potpunosti u saglasnosti sa Konvencijom o pravima deteta kao i nijedno pretpostavljeno tumačenje onoga što je u najboljem interesu deteta može opravdati povredu bilo kakvog priznatog prava Konvencijom.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Zhvillimi gradual i aftësive</p> <p>Parimi i zhvillimit gradual të aftësive, duhet të merret parasysh në përputhje me zhvillimin e aftësive të fëmijës, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që njihen nga legjislacioni në fuqi dhe Konventa dhe t'iu jepet rëndësia e duhur në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, personat e tjerë të besueshëm, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Gradual development of skills</p> <p>The principle of gradual development of skills should be taken into account in accordance with the development of child skills, the proper orientation and direction for the exercise of the rights acknowledged by the legislation in force and the Convention, and provide due importance regarding all child-related decisions and actions that are taken by parents or guardians, other trusted persons, institutions, child protection services, child protection professionals, courts, administrative authorities or legislative bodies.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Postepeni razvoj sposobnosti</p> <p>Princip postepenog razvoja deteta mora se uzeti u obzir u skladu sa razvojem sposobnosti deteta, pravilnim usmeravanjem i vođenjem za ostvarivanje prava priznatih važećim zakonodavstvom i Konvencijom i dati im potrebnu važnost u svim radnjama i odlukama vezanim sa detetom, preduzetih od strane roditelja ili staratelja, drugih poverljivih lica, institucija, službi za zaštitu deteta, profesionalaca za zaštitu deteta, sudova, administrativnih organa ili zakonodavnih organa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Respektimi i pikëpamjes së fëmijës</p> <p>1. Në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, kanë për obligim t'i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Observing the child's point of view</p> <p>1. In all actions and decisions that have to do with the child, taken by parents or guardians, institutions, child protection services, child protection professionals, courts, administrative authorities or legislative bodies, have the obligation to guarantee the child who is capable of having his or her views, the right to freely express such views on any matter pertaining to him/her, by assessing them in accordance with his/her age and degree of maturity, either directly, either</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Poštovanje stava deteta</p> <p>1. U svim radnjama i odlukama vezanim za dete, koje donose roditelji ili staratelji, ustanove, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, sudovi, administrativni organi ili zakonodavni organi, dužni su da garantuju detetu koje je sposobno da ima svoje stavove, pravo na slobodno izražavanje takvih stavova o svim pitanjima koja se odnose na njega, ocenjujući ih u skladu s njegovim uzrastom i stepenom zrelosti, bilo direktno, ili preko jednog</p>

<p>përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Në të gjitha veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Ligji dhe legjislacionit në fuqi, posaçërisht në çështjet administrative dhe procedura gjyqësore, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës, duhet të merren në konsideratë në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës.</p> <p>3. Kjo kërkon që:</p> <p>3.1. Fëmija të merr informacion adekuat rreth procedurave dhe vendimeve, të drejtën për të shprehur pikëpamjet e /tij, rëndësinë dhe efektin e mundshëm të pjesëmarrjes së tij në mënyrë dhe gjuhë që fëmija mund të kuptojë;</p> <p>3.2. Fëmijës i jepet mundësia për të shprehur pikëpamjet dhe dëshirat, si dhe merr ndihmën e nevojshme për ta bërë këtë në një mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues;</p> <p>3.3. Pikëpamjes dhe dëshirave të fëmijës i jepet peshë e duhur kur bëhet</p>	<p>through a representative or an appropriate body, in accordance with the rules of procedure of the legislation in force.</p> <p>2. In all actions undertaken in accordance with this Law and the applicable legislation, especially in administrative matters and court proceedings, the views and wishes of the child should be considered in accordance with the age and degree of maturity of the child.</p> <p>3. This requires:</p> <p>3.1. The child to receive adequate information about the procedures and decisions, the right to express his/her views and the potential importance and effects of his/her participation in the manner and language the child can understand;</p> <p>3.2. The child to have the opportunity to express views and wishes and to obtain the necessary help to do so in a convenient and encouraging environment;</p> <p>3.3. Adequate importance to be given to the child's view and wishes when a</p>	<p>predstavniku ili odgovarajućeg organa, u skladu sa pravilima postupka važećeg zakonodavstva.</p> <p>2. U svim radnjama preduzetim u skladu sa ovim zakonom i važećim zakonodavstvom, posebno u administrativnim pitanjima i sudskim postupcima, stavovi i želje deteta trebaju se uzeti u obzir u skladu sa uzrastom i stepenom zrelosti deteta.</p> <p>3. Ovo zahteva da:</p> <p>3.1. Dete dobija adekvatne informacije o procedurama i odlukama, pravo izražavanja njegovih stavova i značaj i potencijalni efekat njegovog učešća na način i jezik koji dete može razumeti;</p> <p>3.2. Detetu se daje prilika da izrazi stavove i želje i uzima neophodnu pomoć da to učini u jednom pogodnom i ohrabrujućem okruženju;</p> <p>3.3. Stavovi i željama deteta se daje potrebna težina prilikom analize od</p>
--	---	---

<p>një analizë rast pas rasti dhe tregon se fëmija është i aftë të formojë pikëpamjet e veta në një mënyrë të arsyeshme dhe të pavarur;</p> <p>3.4. Fëmija informohet për rezultatet e procedurës dhe i jepet mundësi për t'iu përgjigjur procedurave dhe vendimeve, dhe;</p> <p>3.5. Fëmija merr ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Fëmija, që nuk është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, kanë për obligim t'i garantojnë fëmijës mbrojtjen e njëjtë, sikur në rastet kur fëmija është në gjendje të shpreh pikëpamjet e tij në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi.</p>	<p>case-by-case analysis is conducted and to show that the child is able to form their views in a reasonable and independent manner;</p> <p>3.4. The child to be informed about the results of procedure and is given the opportunity to respond to the procedures and decisions; and</p> <p>3.5. The child to receive free legal aid in accordance with the legislation in force.</p> <p>4. A child who is unable to have his or her views, the child protection services, institutions, child protection professionals, courts, administrative authorities or legislative bodies are obliged to guarantee the same protection to the child as in cases where the child is able to express his or her views in accordance with the rules and procedures of the legislation in force.</p>	<p>slučaja do slučaja i pokazuje da je dete sposobno da formira svoje stavove na jedan razuman i nezavisan način;</p> <p>3.4. Dete se informiše o rezultatima procedura i dobija mogućnost da odgovori na procedure i odluke; i</p> <p>3.5. Dete dobija besplatnu pravnu pomoć u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Dete koje nije sposobno da ima svoje stavove, institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, sudovi, administrativni ili zakonodavna organi dužni su da garantuju detetu istu zaštitu kao u slučajevima kada je u stanju da može da izrazi svoje stavove u skladu sa pravilima i procedurama važećeg zakonodavstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Mos diskriminimi</p> <p>1. Çdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t'i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia,</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Non-discrimination</p> <p>1. All children are entitled to the same rights recognized by the applicable legislation and the Convention and shall be guaranteed such rights without any distinction, regardless of</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Ne diskriminacija</p> <p>1. Svako dete ima pravo na ista prava priznata važećim zakonodavstvom i Konvencijom i da im se one garantuju bez ikakvih razlika, bez obzira na rasu, boju, rod,</p>

<p>gjuha, feja, opinionioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë.</p> <p>2. Të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.</p> <p>3. Prindërit apo kujdestari, anëtarët e familjes, personi i besueshëm, profesionistet për mbrojtjen e fëmijës, të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj fëmijës, mund të iniciojnë procedurë dhe paraqesin fakte para organit kompetent, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi.</p>	<p>race, colour, gender, language, religion, political or other affiliations, national, ethnic or social origin, property, disability, family background or any other condition of the child or his parents or his/her legal representatives.</p> <p>2. All institutions, service providers, child protection professionals must take all appropriate measures, in order for the child to be protected from all forms of discrimination.</p> <p>3. Parents or guardian, family members, trusted persons, professionals for child protection who consider that the principle of equal treatment has not been applied to the child, may initiate the procedure and submit facts before a competent authority in accordance with the provisions of the respective Law on protection from discrimination</p>	<p>jezik, veru, političko mišljenje ili bilo koje drugo mišljenje, nacionalno, etničko ili društveno poreklo, imovinu, nesposobnost, porodično poreklo ili bilo koje drugo stanje deteta ili njegovih/njenih roditelja ili njegovih/njenih pravnih zastupnika.</p> <p>2. Sve institucije, pružaoci usluga, profesionalci za zaštitu deteta treba da preduzmu sve potrebne mere, kako bi dete bilo zaštićeno od svih oblika diskriminacije.</p> <p>3. Roditelji ili staratelji, članovi porodice, poverljivo lice, profesionalci za zaštitu deteta koji smatraju da se princip jednakog tretmana nije primenjen prema detetu može pokrenuti postupak i podneti činjenice pred nadležnim organom u skladu sa odredbama relevantnog zakona o zaštiti od diskriminacije.</p>
<p>KAPITULLI III - MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËS</p> <p>Neni 9 Autoritetet për të drejtat e fëmijës</p> <p>1. Struktura dhe mekanizmat institucional për</p>	<p>CHAPTER III - INSTITUTIONAL MECHANISMS ON THE RIGHTS OF THE CHILD</p> <p>Article 9 Authorities for the rights of the child</p> <p>1. The institutional structures and</p>	<p>POGLAVLJE III - INSTITUCIONALNI MEHANIZMI ZA PRAVA DETETA</p> <p>Član 9 Organi za prava deteta</p> <p>1. Institucionalna struktura i mehanizmi za</p>

<p>të drejtat e fëmijës, në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, janë në nivel qendror dhe lokal.</p>	<p>mechanisms for the rights of the child, in accordance with the scope and responsibilities defined by the applicable legislation, operate both at the central and local level.</p>	<p>prava deteta, u skladu s delokrugom i odgovornostima utvrđenim važećim zakonodavstvom, su na centralnom i lokalnom nivou.</p>
<p>2. Struktura për të drejtat e fëmijës në nivel qendror:</p> <p>2.1. Ministritë përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës;</p> <p>2.2. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;</p> <p>2.3. Njësia përkatëse për Mirëqenie Sociale.</p>	<p>2. The structures for the rights of the child at central level include:</p> <p>2.1. Relevant ministries, based on their scope, covering the rights of the child;</p> <p>2.2. Relevant unit for Good Governance within the Office of the Prime Minister;</p> <p>2.3. Relevant unit for Social Welfare.</p>	<p>2. Struktura za prava deteta na centralnom nivou:</p> <p>2.1. Relevantna ministarstva prema oblasti koje pokrivaju, u pogledu prava deteta;</p> <p>2.2. Odgovarajuća Jedinica za Dobro upravljanje u okviru Kancelarije premijera;</p> <p>2.3. Odgovarajuća jedinica za Socijalnu zaštitu.</p>
<p>3. Struktura për të drejtat e fëmijës në nivel lokal:</p> <p>3.1. Komuna;</p> <p>3.2. Departamentet përkatëse sipas fushës që mbulojnë, në lidhje me të drejtat e fëmijës;</p> <p>3.3. Qendra për Punë Sociale;</p>	<p>3. The structures for the rights of the child at the local level include:</p> <p>3.1. Municipality;</p> <p>3.2. Relevant departments responsible based on their scope covering the rights of the child;</p> <p>3.3. Centre for Social Work;</p>	<p>3. Struktura za prava deteta na lokalnom nivou:</p> <p>3.1. Opština;</p> <p>3.2. Odgovarajuća odjeljenja prema oblastima koje pokrivaju, u pogledu prava deteta;</p> <p>3.3. Centar za socijalni rad;</p>
<p>4. Mekanizmat institucionalë për të drejtat e</p>	<p>4. Institutional mechanisms for the rights of</p>	<p>4. Institucionalni mehanizmi za prava deteta:</p>

<p>fëmijës:</p> <p>4.1.Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>4.3.Këshilli për të Drejtat e Fëmijës;</p> <p>4.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.</p> <p>5. Strukturat dhe mekanizmat në nivel qendror e lokal bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë;</p> <p>6. Strukturat dhe mekanizmat bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë.;</p> <p>7. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me njësinë përkatëse për</p>	<p>the child:</p> <p>4.1. Inter-ministerial Committee on the Rights of the Child;</p> <p>4.2. Council for the Rights of the Child;</p> <p>4.3. Team for the Rights of the Child.</p> <p>5. The mechanisms and structures at both central and local level shall cooperate and coordinate their work in terms of implementing the legislation and government policies on the rights and protection of the child. The coordination of activities on issues related to rights of the child, set out in this law, shall be determined by a sub-legal act of the Government upon proposal of the relevant Unit for Good Governance;</p> <p>6. The mechanisms and structures shall cooperate with non-governmental organizations in terms of implementing policies on the rights of the child, as well as providing necessary child protection services, based on detailed rules determined by a sub-legal act of the Government upon proposal of the relevant Unit for Good Governance;</p> <p>7. The relevant Unit for Good Governance in cooperation with the respective unit for</p>	<p>4.1. Međuministarski odbor za Prava deteta;</p> <p>4.2. Savet za Prava deteta;</p> <p>4.3. Tim za prava deteta.</p> <p>5. Strukture i mehanizmi na centralnom i lokalnom nivou saraduju i koordiniraju svoj rad za sprovođenje državnog zakonodavstva i politika za prava i zaštitu deteta. Koordinacija njihove aktivnosti o pitanjima koja se odnose na prava deteta, predviđena ovim zakonom, utvrđuju se podzakonskim aktom odobrenim od strane Vlade na predlog odgovarajuće jedinice za Dobro upravljanje;</p> <p>6. Strukture i mehanizmi saraduju sa nevladinim organizacijama za ostvarivanje politika za prava deteta, kao i za pružanje usluga potrebnih za njihovu zaštitu, na osnovu detaljnih pravila utvrđenih podzakonskim aktom odobrenim od strane Vlade na predlog odgovarajuće jedinice za Dobro upravljanje.;</p> <p>7. Odgovarajuća Jedinica za Dobro upravljanje u saradnji sa odgovarajućom</p>
--	---	--

<p>Mirëqenie Sociale monitoron zbatimin e këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Roli i institucioneve qendrore për mbrojtjen e fëmijës</p> <p>1. Institucionet qendrore janë të obliguara të zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe programe për mbështetjen e fëmijës dhe atyre që kujdesen për fëmijën, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së fëmijës, parandalimit të rrezikut për jetën, dhunën, neglizhimin, abuzimin, keqpërdorimin, braktisjen dhe shfrytëzimin, të sigurojnë zbatimin sipas standardeve të duhura të këtyre politikave dhe programeve nga ana e institucioneve dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>2. Institucionet marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore, sociale, arsimore, shëndetësore dhe edukuese për parandalimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruar në pikën 1 të këtij neni dhe ofrimin e përkrahjes së nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.</p> <p>3. Të gjitha institucionet dhe shërbimet që</p>	<p>Social Welfare shall monitor the enforcement of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Role of central institutions in child protection</p> <p>1. Central institutions are obliged to develop and implement policies and programs for supporting children and their guardians, with a view to providing child protection, preventing threats to their life, violence, neglect, abuse, mistreatment, abandonment and exploitation. They shall ensure enforcement pursuant to appropriate standards of these policies and programs by institutions and other organizations providing child protection services.</p> <p>2. Institutions shall take all legislative, administrative, social, education and health measures for the prevention, reporting, referral, investigation, treatment, and prosecution of child abuse cases described in paragraph 1 of this Article, and shall provide support to children and their guardians to ensure the protection and well-being of the child.</p> <p>3. All institutions and services that are</p>	<p>jedinicom za Socijalnu zaštitu prati sprovođenje ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Uloga centralnih institucija o zaštiti deteta</p> <p>1. Centralne institucije su obavezne da razviju i sprovede politike i programe za podršku deteta i onih koji se staraju o detetu kako bi se osigurala zaštita dece, sprečavanje opasnosti po život, nasilje, zanemarivanje, zlostavljanje, zloupotreba, napuštanje i iskorišćavanje. Osigurati sprovođenje ovih politika i programa u skladu sa potrebnim standardima od strane drugih institucija i organizacija koje pružaju usluge za zaštitu deteta.</p> <p>2. Institucije će preduzimati sve zakonodavne, administrativne, društvene, socijalne, obrazovne, zdravstvene i vaspitne mere za sprečavanje, izveštavanje, upućivanje, istraživanje, tretiranje i gonjenje slučajeva zloupotrebe deteta, opisanih u stavu 1. ovog člana, kao i obezbeđivanje potrebne podrške deteta i onih koji se staraju za njega, kako bi se osigurala zaštita i blagostanje deteta.</p> <p>3. Sve institucije i službe koje su odgovorne</p>
--	---	--

<p>përgjegjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij Ligji, si dhe janë përgjegjëse për sigurimin e numrit dhe personelit të aftë për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Ligj.</p> <p>4. Qeveria, përmes ministrive dhe njësive përkatëse, është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe standardeve, që të sigurohet qasje për familjet ndaj formave të ndryshme të mbështetjes për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me të gjitha masat dhe programet e mbështetjes në nivel lokal. .</p> <p>5. Kur familja e vendos fëmijën në situatë rreziku për t'u braktisur, abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar ose shfrytëzuar, ose e ekspozon ndaj akteve të shfrytëzimit dhe abuzimit, institucionet përkatëse kanë përgjegjësinë për të mbrojtur fëmijën dhe të sigurojnë kujdesin e përshtatshëm alternativ në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Ministrinë përkatëse, në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe sigurojnë zbatimin e tyre nga</p>	<p>responsible for the care and protection of the child shall, while exercising their duties and drafting policies and legislation, act in accordance with the principles and provisions of this Law, and shall be responsible to ensure the staff capable of performing the duties and responsibilities set forth in this Law.</p> <p>4. The Government, through ministries and relevant units, is responsible for drafting the policies and standards for ensuring that families have access to various forms of child protection support regarding all support measures and programs in local level.</p> <p>5. When the family places the child in risk of being abandoned, abused, neglected, mistreatment or exploited, or exposes the child to acts of exploitation and abuse, the relevant institutions shall have the responsibility to protect the child and provide appropriate alternative care in compliance with applicable legislation.</p> <p>6. Relevant ministries, in accordance with the scope and responsibilities defined by applicable legislation, shall be responsible for drafting policies in the field of child protection and ensure their implementation by</p>	<p>za staranje i zaštitu deteta u vršenju svojih dužnosti i izradi nacrtu politika i zakona moraju delovati u skladu sa principima i odredbama ovog zakona i odgovorne su za obezbeđivanje broja i sposobnog osoblja za obavljanje dužnosti i odgovornosti utvrđenih ovim zakonom.</p> <p>4. Vlada je preko relevantnih ministarstava i jedinica odgovorna za izradu politika i standarda, kako bi osigurala pristup za porodice različitim oblicima podrške o zaštiti deteta o svim merama i programima podrške na lokalnom nivou.</p> <p>5. Kada porodica dovede dete u situaciji opasnosti od napuštanja, zlostavljanja, zanemarivanja, maltretiranja ili iskorišćavanja, ili izloženosti prema delima iskorišćavanja i zlostavljanja, relevantne institucije imaju odgovornost da zaštite dete i osiguraju alternativno prikladno staranje u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Relevantna ministarstva, u skladu sa delokrugom i odgovornostima utvrđenim važećim zakonodavstvom, odgovorna su za izradu politika u oblasti zaštite deteta i obezbede njihovo sprovođenje od strane</p>
---	--	---

<p>ana e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave të tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>7. Ministritë përkatëse bashkëpunojnë me komunat, me njësitë përkatëse komunale, rrethet akademike, ministritë e tjera dhe me palët e interesuara për hartimin e politikave dhe legjislacionit për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e mbrojtjes së fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Roli i Njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë</p> <p>1. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e këtij Ligji, është përgjegjëse që të:</p> <p>1.1. mbështet Komitetin për koordinimin e institucioneve dhe mekanizmave që merren me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe monitoron dhe raporton mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit;</p> <p>1.2. ofron rekomandime për Komitetin dhe Qeverinë, në çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p>	<p>the responsible institutions at the central and local level, as well as other organizations providing child protection in accordance with the applicable legislation.</p> <p>7. Relevant ministries shall cooperate with municipalities, relevant municipal units, academia, other ministries and stakeholders to formulate policies and legislation to ensure the maintenance and advancement of child protection.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Role of the relevant Unit for Good Governance</p> <p>1. In terms of implementation of this Law, the relevant Unit of Good Governance within the Office of the Prime Minister is responsible to:</p> <p>1.1. support the Committee for coordination of institutions and mechanisms that deal with the rights and protection of the child, and monitor and report the implementation of the Committee's recommendations;</p> <p>1.2. provide recommendations to Committee and the Government on issues related to child protection;</p>	<p>nadležnih institucija na centralnom i lokalnom nivou, kao i drugim organizacijama koje pružaju zaštitu za decu, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>7. Relevantna ministarstva saraduju sa opštinama, sa relevantnim opštinskim jedinicama, akademskim krugovima, drugim ministarstvima i zainteresovanim stranama za izradu politika i zakonodavstva za očuvanje nivoa i unapređenja zaštite deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Uloga relevantne Jedinice za Dobro upravljanje</p> <p>1. Relevantna jedinica za dobro upravljanje u okviru Kancelarije premijera, za sprovođenje ovog zakona, odgovorna je da:</p> <p>1.1. podržava Odbor za koordinaciju institucija i mehanizama koji se bave pitanjima i zaštitom deteta, kao i prati i izveštava o sprovođenju preporuka Odbora;</p> <p>1.2. pruža preporuke Odboru i Vladi o pitanjima prava i zaštite deteta;</p>
---	--	--

<p>1.3. rekomandon dhe këshillon Kryeministrin dhe ministritë përkatëse në përputhje me parimet e këtij Ligji dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës, sipas rrethanës mbi çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.4. harton dhe sigurohet që politikat strategjike, programet dhe legjislacioni të jenë në pajtim me standardet e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të praktikave të qeverisjes së mirë;</p> <p>1.5. harton procedura standarde të veprimit për parandalim, identifikim, raportim, referim, hetim, trajtim dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, për të mbrojtur fëmijën;</p> <p>1.6. realizon projekte promovuese për të nxitur vetëdijesimin e popullatës mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijës, legjislacionin në fuqi, edukimin e fëmijës në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, si dhe promovon çdo formë të re të mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>1.7. ngritja e sistemit të monitorimit të</p>	<p>1.3. recommend and advise the Prime Minister and relevant ministries in accordance with the principles of this Law and the Convention on the Rights of the Child, as necessary, on issues related to the rights and protection of the child;</p> <p>1.4. drafts and ensure the compatibility of strategic policies, programs and legislation with standards related to the rights and protection of the child and good governance practices;</p> <p>1.5. drafts standard operating procedures for prevention, identification, reporting, referral, investigation, treatment and persecution of child abuse cases to ensure protection of the child;</p> <p>1.6. Implements promotional projects to promote public awareness on international standards on child rights, applicable legislation, child education in the spirit of peace, dignity, tolerance, freedom, equality and solidarity and promotes any new form of child protection.</p> <p>1.7. establish a monitoring system for</p>	<p>1.3. preporučuje i savetuje premijera i relevantna ministarstva u skladu sa principima ovog zakona i Konvencije o pravima deteta, prema okolnostima o pitanjima prava i zaštite deteta;</p> <p>1.4. izrađuje i osigurava da strateške politike, programi i zakonodavstvo budu u skladu sa standardima prava i zaštite deteta i praksama dobrog upravljanja;</p> <p>1.5. izrađuje standardne operative procedure za sprečavanje, identifikaciju, izveštavanje, upućivanje, istragu, tretiranje i krivično gonjenje slučajeva maltretiranja deteta, radi zaštite deteta;</p> <p>1.6. realizuje promotivne projekte za podizanje javne svesti građana o međunarodnim standardima prava deteta, zakonodavstvu na snazi, vaspitanju deteta u duhu mira, dostojanstva, tolerancije, slobode, jednakosti i solidarnosti i promoviše bilo koji novi oblik zaštite deteta.</p> <p>1.7. uspostavljanje sistema za praćenja</p>
---	--	---

<p>zbatimit të të drejtave të fëmijës sipas kornizës së treguesve për të drejtat e fëmijës;</p> <p>1.8. bashkëpunon me trupa përkatëse qeveritare të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare, në çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.9. përgatit raportin për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës pranë Komitetit për të drejtat e fëmijës në Gjenevë, i cili miratohet nga Komiteti. Raporti, pas miratimit nga Komiteti, bëhet publik;</p> <p>1.10. paraqet raport vjetor, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për zbatimin e këtij Ligji, dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij.</p> <p>2. Njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë, për përmbushjen e mandatit të përcaktuar me këtë ligj i sigurohen resurset e nevojshme njerëzore.</p> <p>3. Të gjitha ministritë dhe komunat janë të obliguara, në kuadër të njësisë përkatëse të</p>	<p>implementation of the rights of the child under the framework of children's rights indicators;</p> <p>1.8. cooperate with relevant government bodies of other states as well as with international organizations in matters concerning the rights and protection of the child;</p> <p>1.9. Prepare a report on the implementation of the Convention on the Rights of the Child for the Committee on the Rights of the Child in Geneva, which is approved by the Committee. After approval by the Committee, the report shall be made public;</p> <p>1.10. Submit an annual report to the Government of the Republic of Kosovo on the implementation of this Law, and may also draft special reports regarding its implementation.</p> <p>2. Necessary human resources shall be provided to the respective Unit for Good Governance, in order to fulfil the mandate defined by this law.</p> <p>3. All ministries and municipalities are obliged, within their respective units, to</p>	<p>sprovodenja prava deteta prema okviru pokazatelja o pravima deteta;</p> <p>1.8. saraduje sa relevantnim državnim organima drugih država, kao i sa međunarodnim organizacijama o pitanjima vezanim za prava i zaštitu deteta;</p> <p>1.9. priprema izveštaj o primeni Konvencije o pravima deteta u Odboru za prava deteta u Ženevi, koju usvojiva Odbor. Izveštaj se objavljuje, nakon usvajanja od strane Odbora;</p> <p>1.10. podnosi Vladi Republike Kosovo godišnji izveštaj o sprovođenju ovog zakona i može da izradi i posebne izveštaje za njegovo sprovođenje.</p> <p>2. Relevantnoj jedinici za Dobro upravljanje za ispunjavanje mandata utvrđenog ovim zakonom osiguraju se neophodni ljudski resursi.</p> <p>3. Sva ministarstva i opštine su obavezne, da u okviru svojih relevantnih jedinica imenuju</p>
--	---	---

<p>tyre, të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij Ligji dhe janë të obliguar që të bashkëpunojnë me Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë.</p> <p>4. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë vendos bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, të cilat merren me mbrojtjen e fëmijës.</p>	<p>assign an entity or relevant officer to coordinate and report the implementation of this Law and are obliged to cooperate with the relevant Unit for Good Governance.</p> <p>4. The relevant Unit for Good Governance shall establish cooperation with civil society organisations that deal with child protection.</p>	<p>relevantnu jedinicu ili službenika za koordinaciju i izveštavanje o sprovođenje ovog zakona i dužna su da sarađuju sa relevantnom jedinicom za dobro upravljanje.</p> <p>4. Relevantna Jedinica za dobro upravljanje uspostavlja saradnju sa organizacijama civilnog društva koje se bave zaštitom deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Njësia përkatëse për Mirëqenie Sociale</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Relevant unit for Social Welfare</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Relevantna jedinica za Socijalnu zaštitu</p>
<p>1. Njësia përkatëse për Mirëqenie Sociale në kuadër të Ministrisë përkatëse për çështje sociale dhe familjare, për zbatimin e këtij Ligji, është përgjegjëse që të:</p> <p>1.1.hartojë politika, në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe të mbështet institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatat e tjera, që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi, në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>1.3.sigurojë dhe të merr masa në ngritjen e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së fëmijës, të të gjitha</p>	<p>1. In terms of implementation of this Law, the relevant unit for Social Welfare within the relevant Ministry for Social and Family Matters is responsible to:</p> <p>1.1.draft policies in the field of child protection and supports the responsible institutions at the central and local level and other organisations that provide protection for children, in accordance with the legislation in force in the process of drafting and implementation of policies in the field of the child protection;</p> <p>1.3. provide and take measures in capacity building in the field of child protection of all institutional structures</p>	<p>1. Relevantna jedinica za Socijalnu zaštitu u okviru relevantnog ministarstva za socijalna i porodična pitanja, za sprovođenje ovog zakona, odgovorna je za:</p> <p>1.1. izradu politike u oblasti zaštite deteta kao i podržava odgovorne institucije na centralnom i lokalnom nivou, kao i druge organizacije koje pružaju zaštitu za decu, u skladu sa važećem zakonodavstvom, u procesu izrade i sprovođenje politika u oblasti zaštite deteta;</p> <p>1.3. obezbeđivanje i preduzimanje mera u izgradnji kapaciteta u oblasti zaštite deteta, svih institucionalnih struktura</p>

<p>strukturave institucionale, që kanë detyrë dhe përgjegjësi mbrojtjen e fëmijës, në nivel lokal dhe qendror;</p> <p>1.5.gjenerojë të dhëna për numrin e saktë të fëmijës sipas moshës dhe të dhënave të tjera të nevojshme që përfitojnë nga shërbimet sociale dhe familjare;</p> <p>1.6.krijojë një sistem të konsoliduar të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe shqyrtimi i ankesave në shkallë të dytë;</p> <p>1.7. të bashkëpunojë ngushtë me njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë;</p> <p>1.8.ushtrojë çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>that have the duty and responsibility of child protection at the central and local level;</p> <p>1.5. generate data on the exact number of children by age and other necessary data on beneficiaries of social and family services;</p> <p>1.6. Establish a consolidated monitoring and inspection system for the quality of social and family services, as well as review second instance complaint</p> <p>1.7. cooperate closely with the relevant unit for Good Governance;</p> <p>1.8. exercise other competencies according to applicable legislation.</p>	<p>koje imaju kao dužnost i odgovornost zaštitu deteta na lokalnom i centralnom nivou;</p> <p>1.5. generisanje podataka o tačnom broju dece prema starosti i drugim potrebnim podacima koji imaju koristi od socijalnih i porodičnih usluga;</p> <p>1.6. stvaranje konsolidovanog sistema praćenja i inspekcije kvaliteta socijalnih i porodičnih usluga, kao i razmatranje žalbi na drugom stepenu</p> <p>1.7. blisku saradnju sa relevantnom jedinicom za Dobro upravljanje;</p> <p>1.8. vršenje bilo koje druge nadležnosti, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Roli i Komunës</p> <p>1. Secila komunë është përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe rintegruese për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara nga Qeveria apo Ministrinë përkatëse.</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Role of the Municipality</p> <p>1. Each municipality is responsible for providing preventive, protection and reintegration measures and services for child protection within its territory according to standards and policies determined by the Government or the relevant Ministries.</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Uloga opštine</p> <p>1. Svaka opština je odgovorna za pružanje usluga i preventivnih, zaštitnih i reintegracionih mera za zaštitu deteta unutar svoje teritorije, u skladu sa standardima i politikama koje je utvrdila Vlada ili relevantna ministarstva.</p>

<p>2. Komunat duhet të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të tyre.</p> <p>3. Komunat përgatisin plane vjetore dhe financim përkatës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>4. Komunat janë të obliguara përmes drejtorive përkatëse, të caktojnë të paktën një zyrtar për mbrojtjen e fëmijës, i cili është i obliguar të bashkëpunojë, të shkëmbejë informata dhe të dhëna me Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë.</p> <p>5. Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore, komunat mund të konsultohen me njësinë përkatëse për qeverisje të mirë dhe ministritë përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera relevante, dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>6. Çdo komunë duhet të ketë së paku tri familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria përkatëse për Mirëqenie</p>	<p>2. Municipalities shall take steps to identify the nature and extent of the need for child protection within their territory.</p> <p>3. Municipalities shall produce annual plans and financing for the development and maintenance of child protection services.</p> <p>4. Municipalities are obliged through respective directorates, to determine at least one child protection officer, who shall be obliged to cooperate, exchange information and data with the relevant Unit for Good Governance.</p> <p>5. During the preparation of their annual plans, municipalities are obliged to consult widely with the relevant unit for good governance, relevant ministries, civil society organisations and other relevant groups and professional groups in their territory on the development, planning and delivery of child protection services.</p> <p>6. Each municipality should have at least three foster families for children without parental care, who are evaluated, trained and approved according to the standards set forth by the relevant Ministry of Social Welfare.</p>	<p>2. Opštine treba preduzeti korake za identifikaciju prirode i obima potrebe za zaštitom deteta unutar svoje teritorije.</p> <p>3. Opštine pripremaju godišnje planove i odgovarajuće finansiranje za razvoj i održavanje službi za zaštitu deteta.</p> <p>4. Opštine su obavezne da kroz nadležna odeljenja imenuju najmanje jednog službenika za zaštitu deteta koji je dužan da saraduje, razmenjuje informacije i podatke sa relevantnom Jedinicom za Dobro upravljanje.</p> <p>5. Tokom pripremanja njihovih godišnjih planova, opštine mogu da se konsultuju sa relevantnim jedinicama za Dobro upravljanje i relevantnim ministarstvima, organizacijama civilnog društva i drugim relevantnim grupama i profesionalnim grupama na svojoj teritoriji u vezi sa razvojem, planiranjem i vršenjem usluge za zaštitu deteta.</p> <p>6. Svaka opština treba da ima najmanje tri hraniteljske porodice za decu bez roditeljskog staranja, procenjene, obučene i odobrene u skladu sa standardima koje je utvrdilo nadležno Ministarstvo za socijalnu zaštitu.</p>
--	--	--

<p>Sociale.</p> <p>7. Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të mbrojtjes së fëmijës, dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>8. Zhvillon programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës.</p> <p>9. Për vetëdijesimin e komunitetit dhe arritjen e rezultateve konkrete dhe të sigurta për fëmijët të cilët nuk kanë qasje në shërbimet ekzistuese, komunat të organizojnë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës, duke koordinuar dhe harmonizon veprimet përmes shërbimeve të integruara të sektorëve të edukimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe organizatave të tjera qeveritare, joqeveritare dhe komunitetit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Roli i Qendrës për Punë Sociale</p> <p>1. Qendra për Punë Sociale në kuadër të komunës, për zbatimin e këtij Ligji, është</p>	<p>7. In order to realize common objectives and interests related to child protection competences, two or more municipalities may enter into cooperation relationships in compliance with applicable legislation.</p> <p>8. develop programs and projects to ensure the rights and welfare of the child, prevent and reduce factors endangering the life and moral, physical, psychological and emotional integrity of the child;</p> <p>9. For the purpose of community awareness and achievement of concrete and certain results for children who do not have access to existing services, municipalities should organize information, education meeting and training for child protection, by coordinating and harmonizing actions through integrated services of the education sectors, social services, health and other governmental, non-governmental and community organizations.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Role of the Centre for Social Work</p> <p>1. In terms of implementation of this Law, the Centre for Social Work within the</p>	<p>7. Za ostvarivanje zajedničkih ciljeva i interesa u vezi sa vršenjem nadležnosti za zaštitu deteta, dve ili više opština imaju pravo da stupe u odnose saradnje, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>8. Opština razvija programe i projekte koji garantuju prava i dobrobit deteta, u cilju sprečavanja ili smanjenja faktora koji ugrožavaju život i moralni, fizički, psihološki i emocionalni integritet deteta;</p> <p>9. U cilju podizanja svesti zajednice i postizanja konkretnih i sigurnih rezultata za decu koja nemaju pristup postojećim uslugama, opštine treba da organizuju informativne, edukacione i sastanke za obuku o zaštiti deteta, koordinacijom i usklađivanjem akcija kroz integrisane usluge obrazovnih sektora, socijalnih usluga, zdravstva i drugih vladinih, nevladinih organizacija i zajednice.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Uloga Centra za socijalni rad</p> <p>1. Centar za socijalni rad u okviru opštine, za sprovođenje ovog zakona, odgovorno je da:</p>
---	--	---

<p>përgjegjëse që të:</p> <p>1.1. koordinojë dhe organizojë sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;</p> <p>1.2. zbatojë politikat nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna;</p> <p>1.3. shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen te shërbimet apo institucionet e tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;</p> <p>1.4. çdo Qendër për Punë Sociale duhet të përcaktojë së paku një zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës. Ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.8. për të përmbushur funksionin e saj Qendra për Punë Sociale kërkon përkrahje dhe ndihmë sipas specifikave të përcaktuara në këtë nen nga njësia përkatëse për mbrojtje nga</p>	<p>municipality is responsible to:</p> <p>1.1. coordinate and organize the integrated child protection system within the municipality;</p> <p>1.2. implement national and local child protection policies, including the implementation of interventions and measures to prevent and protect the child from abuse, negligence, mistreatment and violence;</p> <p>1.3. serve as an information centre where children and families within the municipality can be informed or referred to other support services or institutions, according to their needs;</p> <p>1.4. each Centre for Social Work shall designate at least one relevant responsible and specialized officer to coordinate child protection measures and interventions. It shall also exercise other competencies as defined by the legislation in force;</p> <p>1.8. to carry out its function, the Centre for Social Work shall require support and assistance according to specifications in this article by the relevant unit for protection from</p>	<p>1.1. koordinira i organizuje integrisani sistem zaštite deteta u okviru opštine;</p> <p>1.2. sprovede nacionalne i lokalne politike zaštite deteta, uključujući sprovođenje intervencija i preduzimanje mera za sprečavanje i zaštitu deteta od zlostavljanja, zanemarivanja, maltretiranja i nasilja;</p> <p>1.3. služi kao informacioni centar u kome deca i porodice u okviru opštine mogu biti informisani ili upućeni kod drugih službi ili institucija za podršku, u skladu sa potrebama koje oni imaju;</p> <p>1.4. svaki Centar za socijalni rad treba da odredi najmanje jednog relevantnog odgovornog i specijalizovanog službenika za koordinaciju mera i intervencija u vezi sa zaštitom deteta, i koji vrši svaku drugu nadležnost, u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.8. za ispunjavanje svoje funkcije, Centar za socijalni rad zahteva podršku i pomoć u skladu sa specifikacijama navedenim u ovom</p>
---	--	--

<p>diskriminimi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtën e fëmijës</p> <p>1. Avokati i Popullit është institucion i pavarur i cili ndër të tjera i mbron të drejtat e fëmijës, të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.</p> <p>2. Një zëvendës i Avokatit të Popullit, në kuadër të kompetencave të deleguara nga Avokati i Popullit, duhet të jetë përgjegjës edhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.</p> <p>3. Çdo fëmijë, person apo grup i personave mund t'i parashtojë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin ankesat në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të prindit apo kujdestarit të tij, si dhe mendimin e fëmijës kur ai është në gjendje që të jap atë, për zhvillimin e</p>	<p>discrimination.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Role of Ombudsperson Institution in Child Protection</p> <p>1. The Ombudsperson is an independent institution which, among others, protects the rights of the child provided for in the Constitution, laws and other acts and international instruments on human rights, in particular the Convention on the Rights of the Child.</p> <p>2. A Deputy Ombudsperson, within competencies delegated by the Ombudspersons, shall be responsible for protecting the rights of the child.</p> <p>3. Every child, person or group of persons may appeal before the Ombudsperson regarding the protection of rights of the child in accordance with the procedures set forth in applicable legislation</p> <p>4. Associations, organisations or other legal entities may initiate or support complaints on behalf of the applicant, with the consent of the parents or the guardian, as well as the opinion of the child when he/she is able to provide it, for conducting the proceedings at</p>	<p>članu od strane relevantne jedinice za zaštitu od diskriminacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Uloga institucije Ombudsmana u zaštiti deteta</p> <p>1. Ombudsman je nezavisna institucija koja, između ostalog, štiti prava deteta predviđena Ustavom, zakonima i drugim aktima, kao i međunarodnim instrumentima o ljudskim pravima, a posebno Konvencijom o pravima deteta.</p> <p>2. Jedan zamenik Ombudsmana, u okviru nadležnosti delegiranih od strane Ombudsmana, treba da bude odgovoran i za zaštitu prava deteta.</p> <p>3. Svako dete, lice ili grupa lica može podneti žalbu Ombudsmanu u vezi sa zaštitom prava deteta prema procedurama predviđenim važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Udruženja, organizacije ili drugi pravni subjekti mogu pokrenuti ili podržati žalbe u ime podnosioca zahteva, dobijanjem saglasnosti njegovog roditelja ili staratelja, kao i mišljenja deteta kada je on u mogućnosti da je pruži za vođenje procedura</p>
--	--	--

<p>procedurave tek Avokati i Popullit.</p> <p>5. Kur Avokati i Popullit fillon procedurën me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të fëmijëve, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 4 i këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Komiteti Ndërmintrosor për të Drejtat e Fëmijës</p> <p>1. Komiteti Ndërmintrosor për të Drejtat e Fëmijës themelohet për të komunikuar dhe koordinuar politikën, programet dhe proceset në lidhje me çështjen e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, ndërmjet Institucioneve të Qeverisë së Kosovës, për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe për t'u ofruar atyre mundësi të barabartë për pjesëmarrje aktive në shoqëri.</p> <p>2. Komiteti siguron zbatimin e politikave, programeve dhe proceseve për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>3. Komiteti siguron këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të arsimit, drejtësisë, shërbimeve sociale,</p>	<p>Ombudsperson's office.</p> <p>5. When the Ombudsperson initiates procedures on his/her own initiative regarding the violation of rights and freedoms to a greater number of children, the consent from paragraph 4 of this Article is not required.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Inter-ministerial Committee on the Rights of the Child</p> <p>1. The Inter-Ministerial Committee on the Rights of the Child is established to communicate and coordinate the policies, programs and processes related to the issue of the rights and protection of the child between the institutions of the Government of Kosovo, to facilitate the realization of the rights of the child and to offer them equal opportunities for active participation in society.</p> <p>2. The Committee shall ensure the implementation of policies, programs and processes related to the rights and protection of children.</p> <p>3. The Committee shall provide advice and ensure the coordination of state policies to ensure the rights and protection of children in all areas, in particular in the area of education, justice, social services, health and</p>	<p>pred Ombudsmanom.</p> <p>5. Kada Ombudsman pokrene postupak po sopstvenoj inicijativi u pogledu kršenja prava i sloboda većeg broja dece, saglasnost iz stava 4. ovog člana nije potrebna.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Međuministarski odbor za prava deteta</p> <p>1. Međuministarski odbor za prava deteta zasniva se da komunicira i koordinira politike, programe i procese vezane za pitanje prava i zaštite deteta između institucija Vlade Kosova radi olakšavanja ostvarivanja prava deteta i pružanja jednakih mogućnosti za aktivno učešće u društvu.</p> <p>2. Odbor obezbeđuje sprovođenje politika, programa i procesa za prava i zaštitu deteta.</p> <p>3. Odbor obezbeđuje savetovanje i koordinaciju državnih politika za garantovanje prava i zaštite deteta u svim oblastima, posebno u obrazovanju, pravosuđu, socijalnim službama, zdravstvu i</p>
---	---	--

<p>shëndetësisë dhe kulturës.</p> <p>4. Komiteti ka këto përgjegjësi:</p> <p>4.1. koordinon të gjitha institucionet dhe mekanizmat që merren me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>4.2. debaton për politikat dhe legjislacionin në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>4.3. mbështet zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe të projekteve të tjera provuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>4.4. lehtëson dhe monitoron implementimin e politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>4.5. definon prioritetet dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>4.6. miraton raportin shtetëror për</p>	<p>culture.</p> <p>4. The Committee shall have the following responsibilities:</p> <p>4.1. coordinate all the institutions and mechanisms that deal with the rights and protection of the child;</p> <p>4.2. debate on policies and legislation in the area of the rights and protection of the child;</p> <p>4.3. support the development and implementation of public information campaigns and other pilot projects to raise awareness on the standards of the rights and protection of the child;</p> <p>4.4. facilitate and monitor the implementation of policies, programs and other adopted measures regarding the rights and protection of the child;</p> <p>4.5. define the priorities and measures to be taken to improve the current situation regarding the rights and protection of the child;</p> <p>4.6. approve the state report on the</p>	<p>kulturi.</p> <p>4. Odbor ima ove odgovornosti:</p> <p>4.1. koordinira sve institucije i mehanizme koji se bave pravima i zaštitom deteta;</p> <p>4.2. raspravlja o politikama i zakonodavstvu u oblasti prava i zaštite deteta;</p> <p>4.3. podržava razvoj i sprovođenje kampanji javnog informisanja i drugih pilot projekata kako bi se podigla svest o standardima prava i zaštite deteta;</p> <p>4.4. olakšava i prati sprovođenje politika, programa i drugih odobrenih mera u vezi sa pravima i zaštitom deteta;</p> <p>4.5. određuje prioritete i neophodne mere koje treba preduzeti kako bi se poboljšala trenutna situacija u pogledu prava i zaštite deteta;</p> <p>4.6. usvaja državni izveštaj o primeni</p>
---	--	---

<p>zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijës për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës në Gjenevë;</p> <p>4.7. merr vendime dhe jep rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;</p> <p>4.8. miraton raportin vjetor për të drejtat e fëmijës në Republikën e Kosovës</p> <p>4.9. mban lidhje dhe bashkëpunon ngushtë me organizatat që përfaqësojnë fëmijët dhe me faktorë të tjerë relevantë në fushën e të drejtave të fëmijës;</p> <p>4.10. themelon grupe punuese të nevojshme për trajtimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.</p>	<p>implementation of the Convention on the Rights of the Child for the Committee on the Rights of the Child in Geneva;</p> <p>4.7. take decisions and provide recommendations for improving the protection of children's rights;</p> <p>4.8. approve the annual report on the rights of the child in the Republic of Kosovo;</p> <p>4.9. maintain links and cooperate closely with organizations representing children and other relevant factors in the field of the rights of the child;</p> <p>4.10. establish working groups needed for dealing with issues related to the rights and protection of the child.</p>	<p>Konvencije o pravima deteta u Komitetu za prava deteta u Ženevi;</p> <p>4.7. donosi odluke i daje preporuke za poboljšanje zaštite prava deteta;</p> <p>4.8. odobrava godišnji izveštaj o pravima deteta u Republici Kosovo;</p> <p>4.9. održava veze i blisko saraduje sa organizacijama koje zastupaju decu i sa drugim relevantnim faktorima u oblasti prava deteta;</p> <p>4.10. osniva radne grupe potrebne za tretiranje pitanja prava i zaštite deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Përbërja e Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës</p> <p>1.Komiteti udhëhiqet nga kryeministri dhe përfaqësohet nga ministritë në nivel ministrash.</p> <p>2. Përbërja e komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës caktohet me vendim të</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Composition of the Inter-ministerial Committee on the Rights of the Child</p> <p>1. The Committee shall be headed by the Prime Minister and represented by ministries at ministerial level.</p> <p>2. The composition of the Inter-Ministerial Committee on the Rights of the Child is</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Sastav Međuministarskog odbora za prava deteta</p> <p>1.Odborom predsedava premijer i zastupljen je od strane ministarstava na ministarskom nivou.</p> <p>2. Sastav Međuministarskog komiteta o pravima deteta određuje se odlukom Vlade na</p>

<p>Qeverisë sipas propozimit të Kryeministrit.</p> <p>3.Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues janë: Avokati i Popullit, dy përfaqësues nga këshillat e nxënësve, Kryesuesi i Zyrës së UNICEF-it në Republikës së Kosovës dhe një përfaqësues nga shoqëria civile;</p> <p>4.Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë shërben si Sekretariat i Komitetit, bën koordinimin, monitorimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të nevojshme për punën e Komitetit.</p> <p>5.Përzgjedhja e fëmijës bëhet nga Këshillat e Nxënësve sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>6. Përfaqësuesi nga radhët e shoqërisë civile duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, që ka njohuri dhe ka marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përfaqësuesi nga shoqëria civile duhet të përzgjidhet me anë të procedurave të hapura, transparente dhe demokratike.</p> <p>7. Komiteti takohet së paku dy (2) herë në vit.</p> <p>8. Anëtarët e Komitetit janë përgjegjës për të siguruar përfaqësim të ministrisë përkatëse</p>	<p>determined by a Government decision base on the proposal of the Prime Minister.</p> <p>3. The Ombudsperson, two representatives from student councils, the Head of the UNICEF Office in the Republic of Kosovo and a civil society representative shall be in the quality of observer members;</p> <p>4. The relevant Unit for Good Governance shall serve as the Secretariat of the Committee, coordinating, monitoring, developing and maintaining necessary activities for the Committee’s work.</p> <p>5. The children shall be selected by Student Councils pursuant to the legislation in force;</p> <p>6. The civil society representative shall be a citizen of the Republic of Kosovo who has knowledge of and has participated in outstanding activities in the field of protection of the rights of the child. He/she shall be selected through open, transparent and democratic procedures;</p> <p>7. The Committee shall meet at least two (2) times a year.</p> <p>8. The members of the Committee shall be responsible for ensuring representation of the</p>	<p>predlog premijera.</p> <p>3. U svojstvu članova posmatrača su: Ombudsman, dva predstavnika iz saveta učenika, šef Kancelarije UNICEF-a u Republici Kosovo i jedan predstavnik civilnog društva;</p> <p>4.Odgovarajuća Jedinica za Dobro upravljanje služi kao Sekretarijat Odbora, vrši koordinaciju, praćenje, razvoj i održavanje aktivnosti neophodne za rad Odbora.</p> <p>5. Izbor deteta se vrši od strane Saveta učenika prema važećem zakonodavstvu;</p> <p>6. Predstavnik iz redova civilnog društva treba da bude državljanin Republike Kosovo koji ima znanje i učestvovao je u izuzetnim aktivnostima u oblasti zaštite prava deteta. Predstavnik civilnog društva treba biti izabran otvorenim, transparentnim i demokratskim procedurama;</p> <p>7. Odbor se sastaje najmanje dva (2) puta godišnje.</p> <p>8.Članovi Odbora su odgovorni za obezbeđivanje zastupanja relevantnog</p>
--	---	--

<p>në punën e Komitetit dhe për të përmbushur detyrat që dalin nga ky Komitet.</p> <p>9. Ministritë ofrojnë propozime, këshilla, sugjerime dhe rekomandime për Komitetin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës në lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>10. Në takimet e Komitetit sipas agjendës përkatëse mund të ftohen përfaqësues të institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile, udhëheqës të drejtorive përkatëse, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve dhe personave të tjerë, që kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>11. Obligohen të gjitha institucionet që të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë rekomandimet e Komitetit si dhe të ofrojnë të dhënat e kërkuara nga Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë në emër të Komitetit.</p> <p>12. Komiteti duhet të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën e vet me trupa të tjerë qeveritarë relevantë dhe Koordinatorin Nacional kundër dhunës në familje.</p>	<p>relevant ministry in the work of the Committee and to carry out the duties arising from this Committee.</p> <p>9. The ministries shall provide proposals, advice, suggestions and recommendations to the Committee and the Government of the Republic of Kosovo in relation to the development of policies related to the rights and protection of the child.</p> <p>10. Representatives of independent institutions, civil society organisations, heads of the respective directorates, central and local level, as well as experts and representatives of other institutions and persons that have responsibilities in the field of child protection shall be invited to participate in meetings of the Committee.</p> <p>11. All institutions are obliged to cooperate and to implement the recommendations of the Committee and to provide information required by the relevant Unit for Good Governance, on behalf of the Committee.</p> <p>12. The Committee shall cooperate and coordinate its work with other relevant government bodies and the National Coordinator against Domestic Violence.</p>	<p>ministarstva u radu Odbora i za ispunjavanje zadataka koji proizilaze iz ovog odbora.</p> <p>9. Ministarstva pružaju predloge, savete, sugestije i preporuke za Odbor i Vladu Republike Kosova u vezi sa razvojem politika vezanih za prava i zaštitu deteta.</p> <p>10. Na sastancima odbora, prema relevantnom dnevnom redu mogu se pozvati predstavnici nezavisnih institucija, organizacija civilnog društva, rukovodioci relevantnih odeljenja, centralnog i lokalnog nivoa, kao i stručnjaci i predstavnici institucija i drugih lica, koji imaju odgovornost u oblasti zaštite deteta.</p> <p>11. Sve institucije su dužne da sarađuju i sprovede preporuke Odbora, kao i da pružaju podatke koje zahteva odgovarajuća Jedinica za Dobro upravljanje u ime Odbora.</p> <p>12. Odbor treba da sarađuje i koordinira svoj rad sa drugim relevantnim državnim organima i Nacionalnim koordinatorom protiv nasilja u porodici.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 18 Këshilli për të Drejtat e Fëmijës</p>	<p align="center">Article 18 The Council for the Rights of the Child</p>	<p align="center">Član 18 Savet za prava deteta</p>
<p>1.Këshilli për të Drejtat e Fëmijës ka përgjegjësi:</p> <p>1.1.definimin e prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe koordinimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e tyre;</p> <p>1.2. këshillon Komitetin për të gjitha aspektet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>1.3. koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimit e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë dhe planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijës;</p> <p>1.4.lehtësimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.5. analizimi dhe Vlerësimi i zbatimit të politikave zhvillimore dhe legjislationit që kanë të bëjnë me</p>	<p>1. The Council shall have the following responsibilities:</p> <p>1.1. define the priorities and necessary measures to be taken for improving the current situation regarding the rights and protection of the child, and coordinate the activities necessary for their implementation;</p> <p>1.2. advise the Committee on all aspects of the rights and protection of the child;</p> <p>1.3. coordinate and monitor the development and implementation of relevant policies and measures for implementation of this law and the strategy and national action plan on the rights of the child;</p> <p>1.4. facilitate and monitor the implementation of policies, programs and other adopted measures regarding the rights and protection of the child;</p> <p>1.5. analyse and evaluate the implementation of development policies and legislation related to improving the</p>	<p>1. Savet za prava deteta ima ove odgovornosti:</p> <p>1.1. Određivanje prioriteta i neophodnih mera koje treba preduzeti kako bi se poboljšala trenutna situacija u pogledu prava i zaštite deteta i koordinacija aktivnosti neophodnih za njihovo sprovođenje;</p> <p>1.2. Savetuje Odbor o svim aspektima prava i zaštite deteta;</p> <p>1.3. koordinira i prati razvoj i sprovođenje relevantnih politika i mera za sprovođenje ovog zakona, strategije i nacionalnog akcionog plana o pravima deteta;</p> <p>1.4. olakšavanje i praćenje sprovođenja politika, programa i drugih mera usvojenih u vezi sa pravima i zaštitom deteta;</p> <p>1.5. analiza i procena sprovođenja razvojnih politika i zakonodavstva koje se odnosi na poboljšanje stanja prava i</p>

<p>përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>1.6. Rekomandon institucionet kompetente për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislationin në fuqi;</p> <p>1.7. Rekomandime përkatëse për masat parandaluese ndërsektoriale të mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>1.8. Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve që synojnë ngritjen e pjesëmarrjes së fëmijës në procesin e vendimmarrjes për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.9. Realizimi i fushatave informuese dhe projekteve të tjera promovuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.10. avancimi i bashkëpunimit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivelin qendror dhe lokal, me shoqërinë civile, agjencitë relevante me qëllim të zbatimit të dokumenteve përkatëse (strategjive nacionale dhe sektoriale, programeve, planeve të veprimit etj.);</p>	<p>situation of the rights and protection of the child;</p> <p>1.6. recommend to competent institutions undertaking further actions necessary to realize the rights and ensure the protection of the child in accordance with the legislation in force;</p> <p>1.7. provide relevant recommendations on cross-sector prevention measures for child protection;</p> <p>1.8. promote and develop activities aimed at increasing the participation of the child in the decision-making process related the rights and protection of the child;</p> <p>1.9. implement information campaigns and other promotional projects to raise awareness on the standards of the rights and protection of the child;</p> <p>1.10. advance cooperation on the rights and protection of the child at the central and local level with civil society and relevant agencies with the aim of implementing relevant documents (national and sector strategies, programs, action plans, etc.);</p>	<p>zaštite deteta;</p> <p>1.6. preporučuje nadležnim institucijama da preduzmu dalje radnje neophodne za ostvarivanje prava i zaštite deteta u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.7. relevantne preporuke za međusektorijalne preventivne mere za zaštitu deteta;</p> <p>1.8. promocija i razvijanje aktivnosti koje imaju za cilj povećanje učešća deteta u procesu odlučivanja o pravima i zaštiti deteta;</p> <p>1.9. realizacija informativnih kampanji i drugih promotivnih projekata za podizanje svesti o standardima prava i zaštite deteta;</p> <p>1.10. Unapređivanje saradnje o pravima i zaštiti deteta na centralnom i lokalnom nivou, sa civilnim društvom, relevantnim agencijama radi sprovođenja relevantnih dokumenata (nacionalnih i sektorskih strategija, programa, akcionih planova itd);</p>
---	--	---

<p>1.11.Kryen funksione të tjera që mund të përshkruhen nga aktet nënligjore që nxirren për zbatim të këtij Ligji.</p> <p>3. Anëtarësia, numri i anëtarëve dhe rregullat e procedurës së Këshillit për të Drejtat e Fëmijës rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë dhe të miratuar nga Qeveria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Ekipi për të Drejtat e Fëmijës</p> <p>1.Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet me këtë ligj, në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, në nivel të vendimmarrjes politike.</p> <p>2.Ekipi ka këto përgjegjësi:</p> <p>2.1. definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinojë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e tyre;</p>	<p>1.11. perform other functions that may be defined by sub-legal acts issued for the implementation of this Law.</p> <p>3. Membership, number of members and rules of procedure of the Council for the Rights of the Child shall be regulated by a sub-legal act proposed by the relevant Unit for Good Governance and approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Team for the Rights of the Child</p> <p>1. This law shall establish the Team for the Rights of the Child at the political decision-making level in all Municipalities of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The team shall be responsible to:</p> <p>2.1. define the priorities of the municipality and necessary measures to be taken to improve the current situation regarding the rights and protection of the child and to coordinate the activities necessary for their implementation;</p>	<p>1.11. Obavlja i druge funkcije koje mogu biti opisane podzakonskim aktima izdatim za sprovođenje ovog zakona.</p> <p>3. Članstvo, broj članova i pravila procedure Saveta za prava deteta reguliše se podzakonskim aktom predloženim od strane relevantne Jedinice za Dobro upravljanje i odobrenom od strane Vlade</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Tim za prava deteta</p> <p>1. Tim za prava deteta osniva se ovim zakonom, u svim opštinama Republike Kosovo, na nivou političkog odlučivanja.</p> <p>2. Tim ima ove odgovornosti:</p> <p>2.1. određivanje prioriteta opštine i potrebnih mera koje treba preduzeti za poboljšanje trenutne situacije u pogledu prava i zaštite deteta i koordinirati potrebnih aktivnosti za njihovo sprovođenje;</p>
--	--	---

<p>2.2. koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij Ligji;</p> <p>2.3. kujdeset për zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të nxjerra nga strukturat e parapara sipas këtij Ligji për mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>2.4. vlerëson dhe siguron përputhshmërinë e politikave, akteve juridike dhe masave të tjera të ndërmarra nga Komuna me legjislacionin, politikat, strategjinë për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>2.5. zhvillimi i programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët;</p> <p>2.7. rekomandon kryetarin e komunës për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p>	<p>2.2. coordinate and monitor the implementation of policies and relevant measures for the implementation of this Law;</p> <p>2.3. ensure the implementation of the recommendations and decisions issued by the structures foreseen under this Law on Child Protection;</p> <p>2.4. assess and ensure the compliance of policies, legal acts and other measures taken by the Municipality with legislation, policies, strategy on the Rights of the Child and international standards on child rights and protection;</p> <p>2.5. develop programs for preventing child involvement in potential negative phenomena and reduce risk factors that could endanger children;</p> <p>2.7. recommends the Mayor to undertake further actions necessary to realize the rights and ensure the protection of the child in accordance with the legislation in force;</p>	<p>2.2. koordinira i prati sprovodjenje politika i relevantnih mera za sprovodjenje ovog Zakona;</p> <p>2.3. brine se o sprovodjenju preporuka i odluka koje izdaju strukture predviđene ovim Zakonom o zaštiti deteta;</p> <p>2.4. procenjuje i obezbeđuje usklađenost politika, pravnih akata i drugih mera koje opština preduzima sa zakonodavstvom, politikama, strategijom o pravima deteta i međunarodnim standardima o pravima i zaštiti deteta;</p> <p>2.5. razvijanje programa za sprečavanje uključivanja deteta u mogućim negativnim pojavama i smanjenje faktora rizika koji mogu ugroziti decu;</p> <p>2.7. preporučuje gradonačelniku da preduzme dalje mere neophodne za ostvarivanje prava i obezbeđivanja zaštite deteta u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p>
--	--	---

<p>2.8. mënyra e themelimit dhe funksionimit të Ekipeve për të drejtat e fëmijës rregullohet me akt nënligjore, i cili miratohet nga Qeveria me propozim të Ministrisë përkatëse për Administrimin e Pushtetit lokal dhe Njësisë përkatëse për Qeverisje të Mirë.</p> <p>3. Komuna krijon të gjitha kushtet e nevojshme Ekipit për të Drejtat e Fëmijës për kryerjen e funksionit sipas paragrafit 2 të këtij neni.</p>	<p>2.8. the manner of establishing and functioning of the Team for the Rights of the Child shall be regulated by a sub-legal act approved by the Government upon the proposal of the respective Ministry of Local Government Administration and the relevant Unit for Good Governance.</p> <p>3. The Municipality shall create all the necessary conditions for the Team for the Rights of the Child to perform activities under paragraph 2 of this Article.</p>	<p>2.8. način uspostavljanja i funkcionisanja tima za prava deteta regulisan je podzakonskim aktom kojeg usvaja Vlada na predlog relevantnog Ministarstva za administraciju lokalne samouprave i relevantne Jedinice za Dobro upravljanje</p> <p>3. Opština stvara sve neophodne uslove da Tim za prava deteta obavlja funkciju prema stavu 2. ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20</p> <p style="text-align: center;">Themelimi i Tryezave Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit</p>	<p style="text-align: center;">Article 20</p> <p style="text-align: center;">The establishment of Multidisciplinary Roundtables for Support in Case Management</p>	<p style="text-align: center;">Član 20</p> <p style="text-align: center;">Osnivanje Multidisciplinarnih okruglih stolova za pomoć u upravljanju slučajem</p>
<p>1. Tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve themelohen në komunat e Republikës së Kosovës, në nivel profesionistësh.</p> <p>2. Procedurat e punës, në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, të udhëhequra nga menaxheri i rastit, në koordinim dhe bashkëveprim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, veprojnë mbi bazën e procedurave të detajuara që do të përcaktohen me akt nënligjor, që propozohet nga</p>	<p>1. Multidisciplinary roundtables for assistance in case management shall be established in the municipalities of the Republic of Kosovo, at the professional level.</p> <p>2. Working procedures in multidisciplinary roundtables for assistance in case management, led by the case manager, in coordination and interaction with the structures and services responsible for child protection, shall operate based on detailed procedures that will be determined by a sub-legal act, proposed by the relevant Ministry</p>	<p>1. Multidisciplinarni okrugli stolovi za pomoć u upravljanju slučajevima osnivaju se u opštinama Republike Kosovo, na nivou profesionalaca.</p> <p>2. Radne procedure multidisciplinarnih okruglih stolova za pomoć u upravljanju slučajeva kojima rukovodi rukovodilac slučaja u koordinaciji i sudelovanju sa odgovarajućim strukturama i službama za zaštitu deteta, deluju na osnovu detaljnih procedura koje će se utvrditi podzakonskim aktom, koji predlaže Ministarstvo rada i</p>

<p>Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe aprovohet nga Qeveria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë</p> <p>1. Qeveria ka përgjegjësinë e ndërtimit të një sistemi formal, funksional, institucional për të identifikuar dhe koordinuar mbrojtjen dhe kujdesin për çdo rast fëmije të dyshuar ose të identifikuar si të abuzuar, neglizhuar, të lënë pas dore, keqtrajtuar apo trafikuar.</p> <p>2. Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës përfshin kuadrin ligjor, strukturat, masat dhe veprimet të cilat koordinojnë ndërhyrjet për të parandaluar, identifikuar në kohë, vlerësuar dhe ndërhyrë përmes një plani veprimi multidisiplinar dhe që synon mbrojtjen e fëmijës, si dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës.</p> <p>3. Sistemi formal i mbrojtjes së fëmijës për përgjigje për rastet e fëmijëve në rrezik, drejtohet dhe zbatohet nga punonjës të specializuar të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>4. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë</p>	<p>of Labour and Social Welfare and approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Formal institutional system and phone line for children</p> <p>1. The Government shall be responsible for establishing a functional institutional formal system to identify and coordinate the protection and care in any case where a child is suspected or identified as abused, neglected, mistreated or trafficked.</p> <p>2. Child Protection System includes legal framework, structures, measures and actions which coordinate interventions to prevent, identify in time, evaluate and intervene through a multi-disciplinary action plan and aimed at protecting the child and his/her best interest.</p> <p>3. Formal system for child protection on responding to cases of children at risk is directed and implemented by specialized workers of services for child protection.</p> <p>4. Relevant Unit for Good Governance</p>	<p>socijalne zaštite a odobri Vlada.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Formalni institucionalni sistem i telefonska linija za decu</p> <p>1. Vlada je odgovorna za uspostavljanje jednog formalnog funkcionalnog institucionalnog sistema za identifikaciju i koordinaciju zaštite i staranja o bilo kojem osumnjičenom ili identifikovanom slučaju kao zlostavljanom, zanemarenom, zapostavljenom, maltretiranom, ili trgovanom detetu.</p> <p>2. Sistem za zaštitu deteta uključuje pravni okvir, strukture, mere i radnje koje koordiniraju intervencije za sprečavanje, blagovremeno identifikovanje, procenjivanje i intervenciju kroz multidisciplinarni akcioni plan čiji je cilj zaštita deteta i zaštita najboljeg interesa deteta.</p> <p>3. Formalni sistem zaštite deteta za reagovanja na slučajeve dece izloženih opasnosti rukovodi se i sprovodi od strane specijalizovanih radnika usluga zaštite deteta.</p> <p>4. Relevantna Jedinica za Dobro upravljanje</p>
--	---	--

<p>themelon linjën telefonike falas për Mbrojtjen e Fëmijës. Linja telefonike falas shërben për ofrimin e ndihmës së fëmijëve që kanë nevojë të pyesin dhe këshillohen për të drejtat e tyre, si dhe për të raportuar rastet e dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe trafikimit. Fëmijës duhet t'i ofrohet mbështetje, këshillim dhe shërbim sipas nevojave të shprehura në përputhje me interesin më të mirë të tyre.</p> <p>5. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë për përmbushjen e qëllimit të Linjës telefonike falas bashkëpunon ngushtë me institucionet publike, veçanërisht me Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Roli i personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës</p> <p>1. Personat fizikë dhe juridikë, mund të ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>2. Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe zyrtarët e punësuar në institucionet që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës, duhet të licencohen sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.</p>	<p>establishes the free-of-charge line for Child Protection. The free line will serve children who need to ask and receive advice, and to report cases of violence, abuse, negligence and trafficking. Children should be provided with support, counselling and services pursuant to their needs and in accordance with their best interest.</p> <p>5. Relevant Unit for Good Governance, in order to fulfil the goal of the free-of-charge line shall cooperate closely with public institutions, in particular with the relevant Ministry of Labour and Social Welfare.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 The role of natural and legal persons in provision of services for child protection</p> <p>1. Natural and legal persons can provide child protection services.</p> <p>2. Natural and legal persons including officials employed by institutions that provide child protection services must be licensed under applicable legislation and must meet the conditions and criteria defined.</p>	<p>uspostavlja besplatnu telefonsku liniju za Zaštitu deteta. Besplatna telefonska linija služi za pružanje pomoći deci koja imaju potrebu da pitaju i da se savjetuju o njihovim pravima, kao i da prijavljuju slučajeve nasilja, zlostavljanja, zanemarivanja i trgovanja. Detetu treba pružiti podršku, savetovanje i uslugu prema potrebama izraženim u skladu sa njihovim najboljim interesom.</p> <p>5. Relevantna Jedinica za Dobro upravljanje za ostvarivanja svrhe Besplatne telefonske linije blisko saraduje sa javnim institucijama, posebno sa relevantnim Ministarstvom rada i socijalne zaštite.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Uloga fizičkih i pravnih lica u pružanju usluga za zaštitu deteta</p> <p>1. Fizička i pravna lica mogu pružati usluge za zaštitu deteta.</p> <p>2. Fizička i pravna lica, uključujući i službenike zaposlene u institucijama koji pružaju usluge o zaštiti deteta, trebaju biti licencirani prema važećem zakonodavstvu i moraju ispunjavati utvrđene uslove i kriterijume.</p>
--	--	---

<p>3. Komuna mund të lidhë kontrata vetëm me personat fizikë dhe juridikë të licencuar apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara, për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës, brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime të mbrojtjes së fëmijës në territorin e saj, përmes procedurave të komisionimit dhe kontraktimit sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>4. Ministrinë përkatëse mund të lidhin kontratë me personat fizikë dhe juridikë, mund të jap fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, duke përfshirë lokalet, personat fizikë dhe juridikë të licencuar, apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës në nivel të Kosovës përmes procedurave të komisionimit dhe kontraktimit.</p> <p>KAPITULLI IV - MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS</p> <p>Neni 23 Parandalimi</p> <p>1. Për të siguruar të drejtat dhe mirëqenien e</p>	<p>3. A municipality may contract only natural and legal persons licensed or that meet the conditions and criteria to provide special services for child protection, within their territory, on behalf of the municipality, provided that such contracts are in compliance with the annual plans of the municipality for the services of child protection in its territory, through procedures of commissioning and contracting under the legislation in force.</p> <p>4. Relevant ministries may enter into contract with natural and legal persons and may grant funds and provide any other material assistance, including premises, natural and legal persons licensed or that meet the conditions and criteria to provide special services for child protection in the level of Kosovo through procedures of commissioning and contracting.</p> <p>CHAPTER IV - CHILD PROTECTION MEASURES</p> <p>Article 23 Prevention</p> <p>1. The risks that endanger the well-being and</p>	<p>3. Opština može sklopiti ugovore samo sa fizičkim ili pravnim licima, licenciranim ili koja ispunjavaju utvrđene kriterijume i uslove za pružanje posebnih usluga za zaštitu deteta na svojoj teritoriji u ime opštine, pod uslovom da takvi ugovori budu u skladu sa godišnjim planovima opštine za usluge zaštite deteta na svojoj teritoriji kroz procedure komisije i ugovaranja prema važećem zakonodavstvu.</p> <p>4. Relevantna ministarstva mogu sklopiti ugovore sa fizičkim i pravnim licima, mogu obezbediti sredstva i pružiti bilo koju drugu materijalnu pomoć, uključujući prostorije, licenciranim fizičkim i pravnim licima ili koji ispunjavaju uslove i utvrđene kriterijume za pružanje posebnih usluga za zaštitu deteta na nivou Kosova kroz procedure komisioniranja i ugovaranja.</p> <p>POGLAVLJE IV - MERE ZA ZAŠTITU DETETA</p> <p>Član 23 Sprečavanje</p> <p>1. Da bi se obezbedila prava i blagostanje</p>
--	--	--

<p>fëmijës duhet të parandalohen rreziqet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës. Parandalimi përfshin perceptimin e situatave dhe ngjarjeve që kërcënojnë fëmijën sa më shpejt që të jetë e mundur dhe reagimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e problemeve të zhvillimit dhe sjelljes së fëmijës, problemet që ndodhin në mjedisin familjar, identifikimin e abuzimit dhe rritjen e masave mbrojtëse që promovojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës.</p> <p>2. Institucionet publike, private dhe organizatat jo qeveritare, sipas mandatit të tyre, duhet të zhvillojnë masa për të parandaluar nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese. Masat duhet të bazohen në nevojat e fëmijës, të mbështesin marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe personave që rrisin fëmijën, të mbështesin sjelljen sociale. Masat e tilla duhet të jenë të arritshme, me kohë dhe të kenë një efekt pozitiv afatgjatë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Masat e Mbrojtjes Ligjore</p> <p>1. Qendra për Punë Sociale dhe Policia ndihmojnë dhe ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur familja nuk është në gjendje apo kur ekziston dyshimi i bazuar</p>	<p>development of the child must be prevented in order to ensure the rights and well-being of the child. Prevention shall include the perception of child-threatening situations and events at the earliest time possible as well as their response, including the identification of child development and behavioural problems, problems occurring in the family environment, the identification of abuse and the increase of protective measures that promote the well-being and development of the child.</p> <p>2. Public and private institutions and non-governmental organizations, according to their mandate, should develop measures to prevent the child's need for assistance and to reduce existing problems. Measures should be based on the needs of the child, support the relationship between the child and the persons raising the child, and support social behaviour. Such measures should be achievable, timely, and have a positive long-term effect.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Legal protection measures</p> <p>1. The Centre for Social Work and the Police assist and intervene in families, on referral basis or in cases when the family is unable or when there is a grounded suspicion that the</p>	<p>deteta, trebaju se sprečavati rizici koji ugrožavaju blagostanje i razvoj deteta. Sprečavanje uključuje percepciju situacije i događaja koji ugrožavaju dete što je pre moguće i njihovo reagovanje, uključujući identifikaciju razvoja problema i ponašanja deteta, problemi koji se javljaju u porodičnom okruženju, identifikacija zlostavljanja i povećanje zaštitnih mera koje promovisu blagostanje i razvoj deteta.</p> <p>2. Javne, privatne institucije, i nevladine organizacije, u skladu sa svojim mandatom, treba da razvijaju mere za sprečavanje potrebe deteta za pomoć i smanjenje postojećih problema. Mere treba da budu zasnovane na potrebama deteta, da podržavaju odnose između deteta i osoba koja podižu dete, da podržavaju socijalno ponašanje. Takve mere treba da budu dostižne, blagovremene i da imaju pozitivan dugoročni efekat.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Mere pravne zaštite</p> <p>1. Centar za socijalni rad i policija pomažu i intervenišu u porodici, na osnovu upućivanja ili u slučajevima kada porodica nije u mogućnosti ili kada postoji osnovana sumnja</p>
---	---	---

<p>se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi.</p> <p>2. Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja dhe mbrojtja e prindërve, ose kur për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.</p> <p>3. Institucionet kompetente mbështesin prindërit apo kujdestarin në rritjen fëmijës së tyre dhe duhet të sigurojnë ndihmat e nevojshme të familjes në nevojë, madje qysh në fazat e hershme kur një gjë e tillë del të jetë e nevojshme, si dhe t'i referojë fëmijën dhe familjen në shërbimet e mbrojtjes së fëmijës.</p>	<p>family is unable to protect the child from the risk against his or her life, violence, negligence, maltreatment, abuse and exploitation.</p> <p>2. Child protection shall be realized through undertaking protective measures, implementing interventions to respect the rights of the child and provide services, as needed, which aim at the development and well-being of the child in his or her family environment or by placing him/her in alternative care, when the child is temporarily or permanently deprived of the care of the parents or when, due to his best interest, he or she cannot be left under the care of the parents.</p> <p>3. Competent institutions support the parents or guardian in raising their child and should try to provide the necessary assistance to the family in need, even in the early phases when such a thing is necessary and to refer the child and family to the child protection services.</p>	<p>da porodica nije u mogućnosti da zaštiti dete od životne opasnosti, nasilja, zanemarivanja, maltretiranja, zlostavljanja i iskorišćavanja.</p> <p>2. Zaštita deteta se postiže preduzimanjem zaštitnih mera, sprovođenjem intervencije u cilju poštovanja prava deteta i pružanja usluga u skladu sa potrebama koje imaju za cilj razvoj i blagostanje deteta u njegovom ili njenom porodičnom okruženju ili stavljanjem u alternativno staranje, kada je dete privremeno ili trajno lišeno roditeljskog staranja i zaštite ili kada, zbog njegovog višeg interesa, on ne može biti ostavljen u staranju roditelja.</p> <p>3. Nadležne institucije podržavaju roditelje ili staratelja u podizanju njihovog deteta i trebaju obezbediti neophodnu pomoć porodici u potrebi, čak u ranijim fazama kada se ispostavi da je to neophodno kao i da uputi dete i porodicu u službama za zaštitu deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Detyrimi ligjor për raportim</p> <p>1. Çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që mund t'i</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Legal requirements for reporting</p> <p>1. Any person who notices or has information of a situation or act that a child may be</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Zakonska obaveza za izveštavanje</p> <p>1. Svako lice koje primećuje ili ima informaciju za jednu situaciju ili akt kojim</p>

<p>nënshtrohet, ose që ndaj fëmijës është ushtruar çdo formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtimi, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën përkatëse për punës sociale.</p> <p>2. Prindi ose kujdestari si dhe çdo person tjetër, nëse ka arsye për të dyshuar se ndaj fëmijës është ushtruar dhunë, abuzuar, keqtrajtuar, shfrytëzuar, është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën përkatëse për punës sociale.</p> <p>3. Profesionisti për mbrojtjen e fëmijës, që përfshinë, por nuk kufizohet në: edukator, mësimdhënës, mjek, stomatolog, infermier, psikolog, punonjës social, polic, çdo ofrues i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës publik, privat ose përfaqësues i organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës, dhe kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar dhunë, abuzuar, keqtrajtuar, braktisur, shfrytëzuar apo neglizhuar është i obliguar që rastin ta raportojë me shkrim ose gojarisht në polici, në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave ose në QPS.</p> <p>4. QPS ka si detyrë të njoftojë organin e</p>	<p>subjected to or becomes aware that the child has been subject to any form of physical or mental violence, mistreatment, abandonment, abuse, neglect and exploitation is obliged to report the case by writing or verbally to the Police or the relevant Centre for Social Work.</p> <p>2. If a parent or guardian as well as any other person has a reason to suspect that a child is subject to violence, is abused, mistreated, exploited, then he is obliged to report the case in written or verbally to the police or at the Centre for Social Work.</p> <p>3. Child protection professional that included but is not limited to: educators, teachers, doctors, dentists, nurses, psychologists, social workers, any provider of public or private child protection services or representatives of non-governmental organizations for the protection of the child, and whoever has reason to suspect that a child has experienced violence, abuse, mistreatment, abandonment, exploitation or neglect is obliged to report the case, in written or oral form to the police, to Office for Protection and Assistance of Victims or at CSW.</p> <p>4. CSW has the duty to inform the police in</p>	<p>može biti podvrgnut ili da nad detetom je vršen bilo koji oblik fizičkog ili mentalnog nasilja, maltretiranja, napuštanja, zlostavljanje, zanemarivanja i iskorišćavanje, dužan je da prijavi slučaj, pismeno ili usmeno policiji ili relevantnom Centru za socijalni rad.</p> <p>2. Roditelj ili staratelj, kao i bilo koje drugo lice, ukoliko ima bilo kakav razlog za sumnju da prema njegovom detetu je vršeno nasilje, zlostavljanje, maltretiranje, iskorišćavanje, obavezan je da pismeno ili usmeno prijavljuje slučaj policiji ili nadležnom centru za socijalni rad.</p> <p>3. Profesionalac za zaštitu deteta koji uključuje, ali nije ograničen na: vaspitača, nastavnika, lekara, stomatologa, medicinske sestre, psihologa, socijalnog radnika, policijskog službenika, svaki pružaoc usluga za zaštitu deteta, bilo da je javni ili privatni, ili predstavnik nevladinih organizacija za zaštitu deteta, i svako ko ima razloga da sumnja da je dete pretrpelo nasilje, zlostavljanje, maltretiranje, napuštanje, eksploatacije ili zanemarivanje, dužan je da pismenim ili usmenim putem prijavljuje policiji, Kancelariji za zaštitu i pomoć žrtvama ili u CSR.</p> <p>4. CSR je dužna da obavesti policijskog</p>
--	--	---

<p>policisë në çdo rast të referimit të mbrojtjes së fëmijës dhe anasjelltas, organi i policisë ka si detyrim të njoftojë Qendrën për Punë Sociale, në çdo rast të raportimit të rasteve si të identifikuar, të dyshuar ose të abuzuar.</p> <p>5. Çdo person që e raporton informacionin me besueshmërinë tek institucionet dhe mekanizmi formal duhet të përjashtohet nga çdo detyrim civil apo penal, detyrim që mund të lidhet me aktin e raportimit. Ata duhet të kenë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nëse është e nevojshme për sigurinë e personit.</p> <p>6. Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxjerr akt nënligjor që rregullon procedurat efektive për identifikimin, raportimin, referimin, shfrytëzimin, neglizhimin dhe abuzimin e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Ndarja e fëmijës nga familja</p> <p>1. Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës.</p>	<p>any case of referral of protection of the child or otherwise, the police has the obligation to inform the Centre for Social Work, in any case of reporting cases identified as suspected or abused.</p> <p>5. Every person that reports information with credibility to institutions and formal mechanisms should be excluded from any civil or criminal obligation, or an obligation that could be related with the act of reporting. They should have the right to special protection, if necessary, to ensure the safety of the person.</p> <p>6. The Government of the Republic of Kosovo upon the proposal of the relevant Ministry of Labour and Social Welfare, issues a sub-legal act that regulates the effective procedures for identifying, reporting, and referral of exploitation, neglecting and abuse of the child.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Separation of the child from the family</p> <p>1. The child shall not be taken away from the care of a parent or parents or guardians without their consent or without a court order.</p>	<p>organa u svakom slučaju upućivanja zaštite deteta i obrnuto, policijski organ je dužan da obavesti Centar za socijalni rad u svakom slučaju izveštavanja slučajeva identifikovanih kao osumnjičenih ili zlostavljenih.</p> <p>5. Svako lice koje izveštava informaciju poverljivo kod institucija i formalnih mehanizama treba da se isključi iz bilo koje civilne ili krivične odgovornosti, obaveza koja može biti povezana sa aktom izveštavanja. Oni treba da imaju pravo na posebnu zaštitu ukoliko je to neophodno, radi bezbednosti osobe.</p> <p>6. Vlada Republike Kosovo, na predlog relevantnog Ministarstava rada i socijalne zaštite, izdaje podzakonski akt kojim se uređuju efikasne procedure za identifikaciju, izveštavanje, upućivanje, iskorišćavanje, zanemarivanja i zlostavljanja deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Odvajanje deteta od porodice</p> <p>1. Dete ne treba da se odvajaju od starateljstva roditelja ili njegovog zakonskog staratelja bez njegove saglasnosti ili bez sudskog naloga.</p>
---	---	---

<p>2. Përrjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon 72 orë.</p> <p>3. Para se të skadojë afati prej 72 orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë 21 ditëshe, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime deri në kohë kur çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm.</p> <p>4. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç se në rastet nëse kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe nëse kjo ndarje është e pashmangshme dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë. Nëse fëmija ndahet nga prindërit, kujdestari i tij, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të dëgjohen, konsiderohen dhe dokumentohen në dokumentacionin që hartohet për këtë qëllim. Pikëpamjet e fëmijës duhet të dëgjohen dhe</p>	<p>2. Exceptionally, whenever the guardianship body has grounded reasons to believe that there is serious direct risk to the child's health, safety or well-being, the guardianship body may enter any facility and take the child to a safe place, where he/she will have care for a period not exceeding 72 hours.</p> <p>3. Before the 72-hour period has expired, the guardian body must present the case to the competent court, which decides on the custody of the child. If the circumstances so require, the court may issue an assessment order for a period of 21 days to allow for further investigation and evaluation, to which time the case must be referred to the court for further consideration.</p> <p>4. A child cannot be separated from his/her parents or guardian against his/her will and desire, except in cases when such separation is in the best interest of the child, the child is at risk, or such separation is inevitable, and if this separation is required by law or by a final court decision. If the child is separated from his/her parents or guardian, child's opinions and desires should be taken into consideration and documented in the documentation that is developed for this purpose. The opinion of the child should be heard and documented by social services or the court.</p>	<p>2. Izuzetno, kada organ starateljstva ima razloga da veruje da postoji ozbiljna direktna opasnost po zdravlje, sigurnost ili dobrobit deteta, organ starateljstva može ući u bilo koje mesto i ukloniti dete na jedno sigurno mesto gdje on/ona će imati zbrinjavanje za period koji ne prelazi 72 sata.</p> <p>3. Pre isteka roka od 72 sata, organ starateljstva mora prijaviti slučaj nadležnom sudu, koji odlučuje o starateljstvu deteta. Ukoliko okolnosti to zahtevaju, sud može izdati nalog za procenu u periodu od 21. dana kako bi se omogućila dalja istraga i procena, do kojeg vremena slučaj se mora prijaviti u sudu na dalje razmatranje.</p> <p>4. Dete se ne može odvojiti od svojih roditelja, staratelja protiv svoje volje, osim ako nije u najvišem interesu deteta, ako je dete u opasnosti i ako je to odvajanje neizbežno, i ako ovo odvajanje nalaže zakon ili sudska pravosnažna odluka. Ako se dete odvaja od svojih roditelja, staratelja, mišljenja i želje deteta moraju biti saslušana, razmatrana i dokumentovana u dokumentaciji koja se sastavlja za tu svrhu. Mišljenja deteta moraju se saslušati i dokumentovati od strane socijalnih službi ili suda.</p>
--	--	--

<p>dokumentohen nga shërbimet sociale ose gjykata.</p> <p>5. Në të gjitha procedurat në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësi që të marrin pjesë në procedurë dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.</p> <p>6. Fëmija që është i ndarë nga njëri ose të dy prindërit ka të drejtë që të mbajë lidhje personale dhe takime të drejtpërdrejta, të rregullta me të dy prindërit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.</p> <p>7. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga institucionet kompetente, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga institucionet kompetente) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, sipas kërkesës institucioni u jep prindërve, fëmijës ose kur është rasti një anëtar tjetër të familjes të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhet anëtar i ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Duke siguruar që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.</p>	<p>5. In all procedures pursuant to paragraphs 1 and 2 of this Article, all interested parties shall have the opportunity to participate in the proceedings and give their opinions.</p> <p>6. A child who is separated from one or both parents has the right to maintain personal contact and regular direct meetings with both parents unless this is not in the best interest of the child.</p> <p>7. Where such separation results from any action initiated by competent institutions, such as the detention, imprisonment, exile, deportation or death (including death arising from any cause while the person is in the custody of the State) of one or both parents or of the child, that institution, upon request, provide the parents, the child or, if appropriate, another member of the family with the essential information concerning the whereabouts of the absent member(s) of the family unless the provision of the information would be detrimental to the well-being of the child. Institutions shall further ensure that the submission of such a request shall of itself entail no adverse consequences for the</p>	<p>5. U svim postupcima u skladu sa stavovima 1. i 2. ovog člana, sve zainteresovane strane treba da imaju mogućnost da učestvuju u postupku i da iznesu svoje mišljenje.</p> <p>6. Dete koje je odvojeno od jednog ili oba roditelja ima pravo održavanja ličnih kontakata i redovnih direktnih sastanaka sa oba roditelja, sa izuzetkom slučajeva kada to nije u najboljem interesu deteta.</p> <p>7. Kada je odvajanje rezultat bilo koje mere preduzete od strane nadležnih institucija kao što su pritvor, zatvor, deportacija, proterivanje ili smrt (uključujući smrt zbog bilo kog razloga, kada je lice pritvoreno od strane nadležnih institucija) jednog ili oba roditelja, ili deteta, na zahtev institucije daje roditeljima, detetu ili, kada je to slučaj, drugom članu porodice, detaljne informacije o mestu gde se nalaze član ili članovi porodice, sa izuzetkom u slučajevima kada pružanje takvih informacija narušava dobrobit deteta; osiguravajući se da podnošenje takvog zahteva ne nosi po sebi štetne posledice za zainteresovanu osobu ili osobe.</p>
--	--	--

<p>8. Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ, zbatohet, monitorohet dhe raportohet nga Qendra për Punë Sociale dhe rishikohen rregullisht siç parashihet me legjislacion në fuqi ose me vendim të gjykatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore</p> <p>1. Mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindërore realizohet përmes formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare , siç janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kujdestaria;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. strehimi familjar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. strehimi rezidencial / shtëpitë me bazë në komunitet, adoptimi, dhe;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. jetesa e pavarur e mbikëqyrur.</p> <p>2. Institucionet sigurojnë forma të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>person(s) concerned.</p> <p>8. The decision on the placement of the child in alternative care, shall be executed, monitored and reported by the Centre for Social Work and reviewed regularly as foreseen by applicable legislation or court decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Protection of children without parental care</p> <p>1. The protection of children without parental care is realized through the basic forms of family and legal protection, as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. guardianship;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. family housing;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. residential shelter / community-based houses, adoption and;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. independent supervised living.</p> <p>2. Institutions shall provide forms of protection for children without parental care, based on the legislation in force</p>	<p>8. Odluka o smeštanju deteta u alternativnu brigu, primjenjuje se, nadgleda i izveštava od strane Centar za socijalni rad i redovno se pregleda, kako je predviđeno važećim zakonodavstvom ili odlukom suda.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Zaštita deteta bez roditeljskog staranja</p> <p>1. Zaštita dece bez roditeljskog staranja ostvaruje se kroz osnovne oblike pravne i porodične zaštite, kao što su:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. starateljstvo;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. porodični smeštaj;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. stambeni smeštaj / domovi zasnovani u zajednici, usvajanje i;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. nezavisni život pod nadzorom.</p> <p>2. Institucije obezbeđuju oblike zaštite dece bez roditeljskog staranja, na osnovu važećeg zakonodavstva</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 28 Mbrojta e fëmijës gjatë qëndrimit në strehim familjar</p> <p>1. Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komuna obligohen që t'i ofrojnë mbështetje materiale familjes strehuese për perkujdesje për fëmijën gjatë qëndrimit në strehim familjar.</p> <p>2. Familja strehuese nuk lejohet të ndaj asnjë informatë me personat e paautorizuar, mediat dhe të tjerët lidhur me fëmijën gjatë qëndrimit dhe pas largimit nga qëndrimi në strehim familjar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Child protection while staying in a family shelter</p> <p>1. The relevant Ministry of Labour and Social Welfare and the Municipality are obliged to provide material support to the sheltering family for taking care of the child while staying in a family shelter.</p> <p>2. Sheltering family is not allowed to share any information with unauthorised persons, media and others related to the child during his/her stay and after leaving the family shelter.</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Zaštita deteta za vreme boravka u porodičnom smeštaju</p> <p>1. Relevantno Ministarstvo rada i socijalne zaštite i Opština su obavezne da obezbede materijalnu podršku hraniteljskoj porodici za staranje o detetu za vreme boravka u porodičnom smeštaju.</p> <p>2. Hraniteljskoj porodici nije dozvoljeno da deli bilo koju informaciju sa neovlašćenim licima, medijima i drugima o detetu za vreme boravka i nakon napuštanja porodičnog smeštaja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës</p> <p>1.Me këtë ligj themelohen Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale pran Qendrave për Punë Sociale përkatëse ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore.</p> <p>2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përcakton standardet dhe miraton themelimin e Shtëpisë për Mbrojtjen e Fëmijëve</p> <p>3. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës ofrojnë</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Child Protection Houses</p> <p>1. This law established homes for the Protection of Children from the respective Ministry of Labor and Social Welfare, under the relevant Law on Local Self-Government, under the Centers for Social Work where relevant basic and prosecution courts operate.</p> <p>2. The Ministry of Labour and Social Welfare sets standards and approves the establishment of the Child Protection Houses.</p> <p>3. Child Protection Houses shall provide</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Domovi za zaštitu deteta</p> <p>1.Ovim zakonom se osniva Kuća za zaštitu dece, od strane Ministarstva za rad i socijalna pitanja, na osnovu odgovarajućeg Zakona o lokalnoj samoupravi pri nadležnim Centrima za socijalni rad, gde deluju osnovni sudovi i tužilaštvo.</p> <p>2. Ministarstvo rada i socijalne zaštite postavlja standarde i odobrava osnivanje Doma za zaštitu dece</p> <p>3. Domovi za zaštitu deteta pružaju hitne</p>

<p>shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tri ditë.</p> <p>4. Shtëpitë shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar. Ofrimin e shërbimeve këshilluese, veçanërisht terapive të ndryshme, si dhe shërben si vend strehim i përkohshëm i fëmijëve të cilët nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpi, nuk mund të strehohen në strehim familjar, apo atyre që janë në shtëpi por kërkohet largimi i tyre për shkak të rrezikut të lartë që i kanoset jetës apo shëndetit të tyre.</p> <p>5. Shtëpitë në thelb të punës kanë zbatimin e konceptit të qasjes miqësore, reagimit urgjent, veprimit ndërdisiplinor dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe akterëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e rastit në afat sa më të shkurtër kohor.</p> <p>6. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe donatorët.</p> <p>7. Organizimi dhe fushëveprimi i Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të</p>	<p>emergency child protection services, no longer than three days.</p> <p>4. The houses shall also serve as centres for conducting the procedures in all cases of violence, with special emphasis on offenses against sexual integrity, when the child is a victim or a witness. Provide counselling services, especially for different therapies, and shall also serve as temporary shelter for children who are unable to return home, children who cannot be accommodated in family shelters or children who are at home but are required to leave from there because their lives or health are highly endangered.</p> <p>5. The priority of these centres shall be the implementation of the concept of friendly approach, urgent response, interdisciplinary action and coordination between institutions and stakeholders involved in service delivery and case resolution in the shortest time possible.</p> <p>6. Child Protection Centres shall be funded by the Budget of the Republic of Kosovo and by donors.</p> <p>7. The organization and scope of the Child Protection Centres shall be regulated by a sub-legal act proposed by the respective Ministry of Labour and Social Welfare and</p>	<p>usluge za zaštitu dece, ne duže od tri dana.</p> <p>4. Domovi služe i kao centri za obavljanje postupaka za sv slučajeve nasilja, sa posebnim naglaskom na krivična dela protiv seksualnog integriteta, kada je dete žrtva ili svedok. Pružanje savetodavnih usluga, naročito različitih terapija i služe kao privremeni smeštaj dece koja se ne mogu vratiti kući, ne mogu se smestiti u porodičnom smeštaju ili dece koja su kući ali zahteva se njihovo uklanjanje zbog visokog rizika ugrožavanja njihovog života ili zdravlja.</p> <p>5. Suština rada domova je sprovođenje koncepta prijateljskog pristupa, hitne reakcije, međudisciplinarnе akcije i koordinacije između institucija i aktera uključenih u pružanju usluga i rešavanja slučajeva u najkraćem mogućem roku.</p> <p>6. Domovi za zaštitu dece finansiraju se iz budžeta Republike Kosovo i donatora.</p> <p>7. Organizacija i delokrug Domova za zaštitu dece regulisana je podzakonskim aktom predloženim od strane relevantnog Ministarstva rada i socijalne zaštite i</p>
--	---	---

<p>miratuar nga Qeveria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Monitorimi i masave të mbrojtjes</p> <p>1. Menaxheri i rastit ne QPS dhe Kujdestari i fëmijës janë përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes për fëmijën dhe të paktën një herë në muaj duhet të bëhet rishikimi lidhur me mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj, në konsultim me profesionistët e tjerë të Organit të kujdestarisë.</p> <p>2. Menaxheri i rastit për mbrojtjen e fëmijës duhet të merr pëlqimin e Organit të Kujdestarisë për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familje, duke e argumentuar edhe me dokumentacion përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje është në interesin më të mirë të tij.</p> <p>3. Nëse masa mbrojtëse është caktuar nga Gjykata, Menaxheri i rastit paraqet kërkesën në gjykatë për heqjen e masës mbrojtëse.</p> <p>4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë</p>	<p>approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Monitoring of protection measures</p> <p>1. The Case Manager in the CSW and the child Guardian are responsible for monitoring the child protection measures and at least once a month, review the progress, advancement of the measure and/or the need to amend or change it, in consultation with other professionals of the Guardian Body.</p> <p>2. The Case Manager on Child Protection shall have the consent of Guardian Body for the removal of the protection measure and the return of the child to the family, proving with relevant documentation that the parents are able to care for the child and the return of the child in the family is in his/her best interest.</p> <p>3. If the protective measure is imposed by the Court, the Case Manager submits a request to the court for the removal of the protective measure.</p> <p>4. If the parent, in the framework of the Individual Protection Plan, is obliged to attend parenting courses, or perform any</p>	<p>usvojenim od strane vlade.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Praćenje zaštitnih mera</p> <p>1. Rukovodilac slučaja u CSR-u i staratelj deteta su odgovorni za praćenje mera zaštite deteta i najmanje jednom mesečno treba provesti pregled o toku, napretku mere i/ili o potrebi za njenom izmenom ili ukidanjem u konsultaciji sa drugim stručnjacima Organa starateljstva.</p> <p>2. Rukovodilac slučaja za zaštitu deteta treba da dobije saglasnost Organa starateljstva za ukidanje mere zaštite i povratak deteta u porodicu, argumentirajući je relevantnom dokumentacijom koja potvrđuje da su roditelji u stanju da se staraju o detetu i da je povratak deteta u porodici u njegovom najboljem interesu.</p> <p>3. Ukoliko je zaštitnu meru odredio Sud, Rukovodilac slučaja podnosi zahtjev sudu za ukidanje zaštitne mere.</p> <p>4. Ukoliko su u okviru Individualnog plana zaštite roditelji bili dužni da pohađaju roditeljske kurseve ili da obave bilo koju</p>
---	--	---

<p>ndonjë veprim tjetër, zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.</p>	<p>other activities, the relevant child protection officer shall verify the successful fulfilment of these obligations by the parents and include the relevant information in the proposal to remove the protection measure..</p>	<p>drugu radnju, odgovarajući službenik za zaštitu deteta potvrđuje uspešno izvršenje ovih obaveza za roditelje i uključuje relevantnu informaciju u predlogu za ukidanje zaštitne mere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Masat për aftësim prindëror</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Parenting skills measures</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Mere za roditeljsko osposobljavanje</p>
<p>1. Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.</p>	<p>1. The relevant child protection officer, in collaboration with the Team for the Rights of the Child, has the duty to assess the family situation of every child in need of protection and, in any case, with priority, aim at ensuring child protection within the family.</p>	<p>1. Odgovarajući službenik za zaštitu deteta, u saradnji sa Timom za prava deteta, dužan je da proceni porodičnu situaciju svakog deteta kome je potrebna zaštita i da u svakom slučaju ima za cilj, uz prioritet, ostvarivanje njegove zaštite u porodici.</p>
<p>2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtjeje të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.</p>	<p>2. If the protection measure for placing the child in alternative care is taken, the child protection officer, when possible, shall draft a Parenting Skills Plan, which is part of the Individual Protection Plan for the child and aims at preparing the parents for the return of the child in the family, once the protection measure terminates.</p>	<p>2. U slučajevima kada se za dete preduzimaju zaštitne mere smeštaja alternativnog staranja, radnik za zaštitu deteta, kad je to moguće, izrađuje plan za roditeljsko osposobljavanje, koji je deo Individualnog plana zaštite dece i ima za cilj pripremanje roditelja za povratak deteta u porodicu nakon prestanka zaštitne mere.</p>
<p>3. Plani për aftësim prindëror mund të përmbajë, por nuk kufizohet, masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor</p>	<p>3. The Parenting Skills Plan may contain, but is not limited to, measures obliging parents to attend parenting skills courses, psychological counselling for anger management, medical treatment against alcohol or use of narcotic</p>	<p>3. Plan za roditeljsko osposobljavanje može uključiti, ali ne ograničava se na, obavezu roditelja da pohađaju kurseve roditeljskog osposobljavanja, psihološkog savetovanja, kontrole besa, lečenje od alkoholizma ili</p>

<p>kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës sociale, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.</p> <p>4. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror monitorohet nga zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.</p>	<p>and psychotropic substances, mental health treatment, as well as interventions to support the family for registration with the civil registry office, the economic aid scheme, employment services, health services, and any other interventions that would improve family situation and guarantee the child protection within the family.</p> <p>4. Implementation of the Parenting Skills Plan shall be monitored by the child protection officer, in collaboration with the Team for the Rights of the Child.</p>	<p>korišćenja narkotičnih i psihotropnih supstanci, lećenje mentalnog zdravlja i intervencije za podršku porodice za civilnu registraciju, u šemi socijalne pomoći, službi za zapošljavanje, zdravstvenoj službi i sve druge intervencije koje bi poboljšale porodičnu situaciju i garantovale zaštitu deteta unutar porodice.</p> <p>4. Sprovođenje plana za roditeljsko osposobljavanje prati odgovarajući službenik za zaštitu dece u saradnji sa Timom za prava deteta.</p>
<p>KAPITULLI V - MBROJTJA E FËMIJES NË FAMILJE DHE KOMUNITET</p> <p>Neni 32 E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin</p> <p>1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:</p> <p>1.1. të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të</p>	<p>CHAPTER V - CHILD PROTECTION IN FAMILY AND COMMUNITY</p> <p>Article 32 The right to a name, citizenship, knowing his or her parents and preserving the identity</p> <p>1. Pursuant to the applicable legislation, the child is entitled to:</p> <p>1.1. register for free, immediately upon birth. This right is also granted to children born outside the territory of the Republic of Kosovo, upon request by the</p>	<p>POGLAVLJE V - ZAŠTITA DETETA U PORODICI I ZAJEDNICI</p> <p>Član 32 Pravo na ime, državljanstvo, poznavanje roditelja i očuvanje identiteta</p> <p>1. U skladu sa važećim zakonodavstvom, dete ima pravo:</p> <p>1.1. da se registruje besplatno, odmah po svom rođenju. Ovo pravo takođe imaju i deca rođena van teritorije Republike Kosovo na zahtev roditelja ili</p>

<p>prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.2. të ketë një emër;</p> <p>1.3. të fitojë shtetësinë;</p> <p>1.4. të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesjen e plotë të prindërve.</p> <p>2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.</p> <p>3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:</p> <p>3.1. gjetjen e prindërve;</p> <p>3.2. gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e</p>	<p>parent or guardian, according to the rules set forth in the legislation in force;</p> <p>1.2. have a name;</p> <p>1.3. acquire citizenship;</p> <p>1.4. know and be cared for by his or her parents</p> <p>2. The child has the right to preserve the identity, including the determination of the surname, acquisition of citizenship and recognition of family relations in accordance with the applicable law without unlawful interference.</p> <p>3. If a child is unlawfully deprived of one or more elements of his/her identity, he or she shall be provided with the appropriate assistance to restore him/her to identity, including ensuring the care of state institutions, give him/her with the opportunity of practicing religion, culture and language of origin. Assistance may include the provision of genetic information for:</p> <p>3.1. finding the parents;</p> <p>3.2. finding relatives or family members of the child, refugees and asylum seekers</p>	<p>staratelj, u skladu s pravilima propisanim važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.2. da ima ime;</p> <p>1.3. da dobija državljanstvo;</p> <p>1.4. da poznaje roditelje i da uživa potpuno staranje roditelja</p> <p>2. Dete ima pravo da sačuva identitet, uključujući određivanje prezimena, sticanje državljanstva i priznavanje porodičnih veza, u skladu sa važećim zakonodavstva, bez nezakonitog uplitanja.</p> <p>3. Ukoliko je dete nezakonito lišeno jednog ili više elemenata njegovog identiteta, njemu će biti pružena odgovarajuća pomoć kako bi se vratio u identitet, uključujući i osiguranje staranja državnih institucija, kako bi mu se pružila mogućnost da praktikuje religiju, kulturu i jezik porekla. Pomoć može uključivati pružanje genetskih informacija za:</p> <p>3.1. pronalaženje roditelja;</p> <p>3.2. pronalaženje rođaka ili članova porodice deteta, izbeglica i tražioaca</p>
---	--	---

<p>azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;</p> <p>3.3. regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.</p> <p>4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, caktohet menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>6. Kur fëmija braktiset nga prindi/ërit biologjik, apo deklarohet se do ta braktisin fëmijën, personeli social dhe mjekësor në maternitet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, brenda 24 orëve, njofton me telefon dhe me shkrim Qendrën për Punë Sociale në komunën përkatëse.</p> <p>7. Ne rastet e braktisjes së fëmijëve nga</p>	<p>for the purpose of family reunion;</p> <p>3.3. registration of any change of the child's identity, such as name, citizenship, parental rights.</p> <p>4. The registration and confirmation of the fact of birth shall be made in accordance with the criteria, rules, and procedure provided for in the applicable in legislation.</p> <p>5. If not possible to determine the identity a child found or abandoned in the facilities of the healthcare institutions, or the identity of the child's parents, one or more employees of the institution where the child is found or abandoned shall be immediately appointed to take care of the child until the necessary measures are taken in accordance with the applicable legislation.</p> <p>6. When the child is abandoned by his/her biological parent/s, or the same declare that they will abandon the child, the social and medical staff in the maternity or other healthcare institutions shall, within 24 hours, notify by phone and in writing the Centre for Social Work in the respective municipality.</p> <p>7. In cases of child abandonment by unknown</p>	<p>azila, u cilju spajanja porodice;</p> <p>3.3. registraciju svake promene identiteta deteta, kao što su ime, državljanstvo, roditeljska prava.</p> <p>4. Registracija i potvrđivanje činjenice o rođenju vrši se u skladu sa kriterijumima, pravilima i postupkom predviđenim važećim zakonodavstvom.</p> <p>5. Ukoliko nije moguće utvrditi identitet deteta pronađenog ili napuštenog u prostorijama institucija zdravstvene zaštite ili identiteta roditelja deteta, odmah se odredi jedan ili više zaposlenih u instituciji u kojoj je dete pronađeno ili napušteno, da se brine o detetu do preduzimanja potrebnih mera, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Kada se dete napušta od biološkog/ih roditelja ili se prijavljuje da napuštati dete, socijalno i medicinsko osoblje u porodilištima ili drugim institucijama zdravstvene zaštite u roku od 24 sata obaveštava telefonom i pismenim putem Centra za socijalni rad u dotičnoj opštini.</p> <p>7. U slučajevima napuštanja dece od</p>
--	--	---

<p>prindër e panjohur në ambiente jashtë institucioneve shëndetësore, ku rrezikohet jeta dhe shëndeti i fëmijës, Qendra për Punë Sociale, në bashkëpunim me Policinë, përgatisin raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.</p> <p>8. Qendra për Punë Sociale, në cilësinë e Organit të Kujdestarisë i ndërmarr masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në vlerësimin e nevojave të fëmijës.</p> <p>9. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, Qendra për Punë Sociale në komunën përkatëse, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes, këshillon prindin për rëndësinë e marrjes së fëmijës biologjik në përkujdesje prindërore, si dhe efektet ligjore në rast të braktisjes së fëmijës. Nëse pas hetimit të policisë nuk identifikohet nëna e fëmijës, zyrtari për mbrojtjen e fëmijës në komunën ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6 të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.</p>	<p>parents at the premises outside healthcare facilities, whereby the life and health of the child is threatened, the Centre for Social Work, in cooperation with the Police, prepare a written report on the abandonment of the child, which is signed by both sides.</p> <p>8. The Centre for Social Work, in the capacity of the Guardianship body, shall take the necessary measures to protect the child based on the child's needs assessment.</p> <p>9. If one of the parents is identified, the Centre for Social Work in the respective municipality shall, with the purpose of taking the necessary measures to return the child to the biological family and issues a birth certificate, advises the parent on the importance of taking the biological child in parental care and the legal consequences of abandoning a child. If the child's mother is not identified after the police investigation, the child protection official in the municipality where the child was born prepares the file containing the act of birth, the report prepared according to point 6 of this article, the decision on the child protection measure and the information sent by the police about the outcome of the investigations carried out.</p>	<p>nepoznatih roditelja u prostorijama izvan zdravstvenih institucija gde je život i zdravlje deteta ugroženo, Centar za socijalni rad u saradnji sa policijom priprema pismeni izveštaj o činjenici napuštanja deteta, koji potpisuju obe strane.</p> <p>8. Centar za socijalni rad, u svojstvu Organa starateljstva, preduzima potrebne mere za zaštitu deteta, na osnovu procene potreba deteta</p> <p>9. Ukoliko se jedan od roditelja identifikuje, Centar za socijalni rad u relevantnoj opštini, u cilju preduzimanja potrebnih mera za vraćanje deteta u biološkoj porodici i izdavanja izvoda iz matične knjige, savetuje roditelja o važnosti uzimanja biološkog deteta u roditeljsko staranje, kao i pravne efekte u slučaju napuštanja deteta. Ukoliko majka deteta nije identifikovana nakon policijske istrage, službenik za zaštitu deteta u opštini u kojoj se dete rodilo, priprema dosje koji sadrži čin rođenja, izveštaj pripremljen prema tački 6. ovog člana, odluku o meri zaštite deteta i informaciju koje je poslala policija o ishodu izvršenih istraga.</p>
---	---	---

<p>10. Të gjithë personat juridikë e fizikë, veçanërisht institucionet e kujdesit shëndetësor, shërbimit social, shërbimit rezidencialë, që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, të njoftojnë Qendrën për Punë Sociale në komunën ku veprojnë. Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me institucionet e tjera në komunë, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>10. All legal and natural persons, in particular healthcare institutions, social services, residential services that identify pregnant women or children without identification documents, notify the Centre for Social Work in the municipality where they are operating. The Centre for Social Work in cooperation with other institutions in the municipality takes concrete actions to determine the identity of the pregnant woman or the child according to the legislation in force.</p>	<p>10. Sva pravna i fizička lica, posebno institucije zdravstvene zaštite, socijalne službe, stambene službe, koje identifikuju trudne žene ili decu bez identifikacionih dokumenata, obaveštavaju Centar za socijalni rad u opštini u kojoj deluju. Centar za socijalni rad u saradnji sa drugim institucijama u opštini preuzima konkretne radnje za utvrđivanje identiteta trudnice ili deteta prema važećem zakonodavstvu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 33 Përgjegjësitë familjare</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Family responsibilities</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Porodične odgovornosti</p>
<p>1. Familja, duke qenë njësi themelore e shoqërisë dhe mjedisit natyror, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës. Familja duhet të sigurojë që fëmija të rritet në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi e cila nxit zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.</p>	<p>1. The family, being a fundamental unit of society and the natural environment, has as its main responsibility the growth, well-being, education and child protection. The family should ensure that the child grows up in an atmosphere of happiness, love and understanding that promotes the development of the full potential of the child.</p>	<p>1. Porodica, kao osnovna jedinica društva i prirodnog okruženja, ima primarnu odgovornost za podizanje, blagostanje, obrazovanje i zaštitu dece. Porodica treba da obezbedi da dete odraste u atmosferi sreće, ljubavi i razumevanja što podstiče razvoj potpunog potencijala deteta.</p>
<p>2. Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestari duhet të mbrojnë jetën dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe të respektojnë dinjitetin, vlerat dhe personalitetin e fëmijës. Metodat e edukimit duhet të vlerësojnë dhe mbrojnë individualitetin e fëmijës, seksin, gjendjen shëndetësore, aftësitë e kufizuara</p>	<p>2. Parents, other family members and guardians must protect the child's life and development and respect the dignity, values and personality of the child. Educational methods should evaluate and protect the child's individuality, sex, health status, disability, and the ethnic, racial, religious and</p>	<p>2. Roditelji, drugi članovi porodice i staratelji moraju zaštititi život i razvoj deteta i poštovati dostojanstvo, vrednosti i ličnost deteta. Obrazovne metode treba da ocenjuju i zaštite individualnost deteta, pol, zdravstveno stanje, ograničene sposobnosti, etnički, rasni, verski i kulturni identitet deteta. Stavove i</p>

<p>dhe identitetin etnik, racial, fetar dhe kulturor të fëmijës. Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të merren parasysh në pajtim me moshën, pjekurinë dhe zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës për të formuar vendime që ndikojnë në jetën e tij.</p> <p>3. Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestarët janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha aktet dhe situatat që e vënë fëmijën në rrezik, nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimit, abuzimit, keqtrajtimit, dhe shfrytëzimit.</p> <p>4. Prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestarët kanë për detyrë të:</p> <p>4.1. ofrojnë këshilla dhe udhëzime të mira, si dhe ndihmën për fëmijën në përputhje me zhvillimin e tij dhe ta përgatitin atë për një jetë të pavarur dhe të përgjegjshme në shoqëri;</p> <p>4.2. marrin parasysh qëndrimin e fëmijës dhe dëshirat e tij në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij;</p> <p>4.3. respektojnë dhe promovojnë të drejtën e fëmijës për shëndet, arsim dhe edukim, mirëqenie dhe pjesëmarrje;</p> <p>4.4. mbrojnë të drejtat dhe interesat e</p>	<p>cultural identity of the child. The child's opinions and desires should be taken into account in accordance with the age, maturity and gradual development of the child's ability to make decisions that affect his or her life.</p> <p>3. Parents, other family members and guardians are responsible for protecting children from all acts and situations that put the child at risk of all forms of physical and mental violence, neglect, abuse, maltreatment, and exploitation.</p> <p>4. Parents, other family members and guardians shall be obliged to:</p> <p>4.1. provide good advice and guidance and assistance to the child in accordance with his/her development to prepare him/her for an independent and responsible life in society</p> <p>4.2. take into account the position of the child and his/her desires in accordance with his/her age and maturity;</p> <p>4.3. respect and promote the right of the child to health, education, social welfare and participation;</p> <p>4.4. protect the rights and interests of the</p>	<p>želje deteta treba uzimati u obzir u skladu sa uzrastom, zrelošću i postepenim razvojem sposobnosti deteta za oblikovanje odluka koje utiču na njegov/njen život.</p> <p>3. Roditelji, ostali članovi porodice i staratelji su odgovorni za zaštitu dece od svih radnji i situacija koje ugrožavaju dete od svih oblika fizičkog i mentalnog nasilja, zanemarivanja, zlostavljanja, maltretiranja i iskorišćavanja.</p> <p>4. Roditelji, drugi članovi porodice i staratelji su dužni da:</p> <p>4.1. pružaju dobar savet i uputstva i pomoć detetu u skladu sa njegovim razvojem i pripremaju ga za nezavisan i odgovoran život u društvu;</p> <p>4.2. uzimaju u obzir stav i želje deteta u skladu sa njegovim uzrastom i zrelošću;</p> <p>4.3. poštuju i promovišu prava deteta na zdravlje, obrazovanje i vaspitanje, dobrobit i učešće;</p> <p>4.4. zaštite prava i interese deteta</p>
--	--	---

<p>fëmijës të mbrojtur me ligj dhe Konventë, dhe;</p> <p>4.5.sigurojnë që në mungesë të përkohshme të prindit apo kujdestarit, fëmija duhet të ketë kujdesin adekuat nga personi i caktuar, nga prindi, kujdestari apo organi kompetent.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Përgjegjësitë institucionale</p> <p>1 Prindërit ose kujdestari kanë të drejtë të marrin mbështetje nga institucionet për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen. Institucionet duhet të respektojnë përgjegjësinë kryesore të prindërve ose kujdestarëve për edukimin e fëmijës dhe marrëdhëniet midis fëmijës dhe prindërve ose kujdestarit të tij ligjor, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar dhe duke marrë parasysh zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës.</p> <p>2.Institucionet ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që prindërit ose kujdestari, që nuk kanë mundësi të kryerjes së përgjegjësive të tyre, të marrin ndihmën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë dhe sigurojnë infrastrukturën dhe shërbimet e</p>	<p>child protected by law and the Convention; and</p> <p>4.5. ensure that in the temporary absence of parent or guardian, the child has adequate care by the designated person, parent, guardian or competent body.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Institutional responsibilities</p> <p>1. Parents or guardians shall be entitled to support from institutions to fulfil the responsibilities specified in this article. Institutions must respect the primary responsibility of the parents or guardians for education of the child and the relationship between the child and the parents or legal guardian, while at the same time respecting and taking into account the gradual development of skills of the child.</p> <p>2. Institutions should undertake all necessary measures to ensure that the parents or guardians, who are unable to perform their responsibilities, receive the necessary support to fulfil their responsibilities and provide the necessary infrastructure and services in this</p>	<p>zaštićenih zakonom i Konvencijom; i</p> <p>4.5. obezbeđuju da u privremenom odsustvu roditelja ili staratelja dete treba da ima adekvatno staranje od strane osobe određene od roditelja, staratelja ili nadležnog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Institucionalne odgovornosti</p> <p>1. Roditelji ili staratelj imaju pravo da dobiju podršku od institucija da ispune obaveze navedene u ovom članu. Institucije treba da poštuju glavnu odgovornost roditelja ili staratelja za obrazovanje dece i odnos između deteta i njegovih roditelja ili zakonskog staratelja, istovremeno poštujući i uzimajući u obzir postepeni razvoj sposobnosti deteta.</p> <p>2. Institucije preduzimaju sve neophodne mere kako bi obezbedile da roditelji ili staratelji koji nisu u mogućnosti da obavljaju svoje dužnosti, dobijaju neophodnu pomoć da bi ispunili svoje odgovornosti i obezbedili neophodnu infrastrukturu i usluge u tom</p>
--	---	--

<p>nevojshme në këtë drejtim.</p> <p>3. Kur familja dështon të mbrojë ose e vë fëmijën në rrezik nga çdo formë e dhunës fizike dhe mendore, neglizhimi, abuzimi, abuzimi seksual, keqtrajtimi, braktisja, shfrytëzimi ekonomik dhe të gjitha format e tjera të shfrytëzimit, nga prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdestari.; institucioni kompetent komunal është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës dhe sigurimin e kujdesit të duhur alternativ ose perkujdesje të përhershme ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Vetëm kur masat mbështetëse të disponueshme për familjet sipas paragrafit (1) tregojnë se janë të pamjaftueshme për të parandaluar dhunën, shpërfilljen, neglizhimin, abuzimin, keqpërdorimin, shfrytëzimin ose kur fëmija është në rrezik të lartë, të pashmangshëm, institucionet janë përgjegjës për të ndërhyrë me masat e parashikuara nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Përgjegjësia individuale</p> <p>Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij Ligji, kur, me</p>	<p>direction.</p> <p>3. When a family fails to protect or places the child at risk of all forms of physical and mental violence, negligence, abuse, sexual abuse, maltreatment, abandonment, economic exploitation and all other forms of exploitation by parents, other family members and guardian, the competent municipal institution is responsible for protecting the child and ensuring the appropriate alternative care or permanent legal care with the legislation in force.</p> <p>4. Only in cases when support measures available to the families under paragraph (1) prove to be insufficient in preventing violence, disregard, negligence, abuse, maltreatment, exploitation or when the child is at high inevitable risk, institutions shall be responsible to intervene with the measures provided by this law and the legislation in force and to ensure the safety and well-being of the child.</p> <p style="text-align: center;">Article 35 Individual responsibility</p> <p>Every legal and natural person shall be responsible pursuant to the provisions of the</p>	<p>pogledu.</p> <p>3. Kada porodica ne uspeva da zaštiti ili dovodi dete u rizik od svakog oblika fizičkog i mentalnog nasilja, zanemarivanja, zlostavljanja, seksualnog zlostavljanja, maltretiranja i napuštanja, ekonomskog iskorišćavanja i svih drugih oblika iskorišćavanja, od roditelja, drugih članova porodice i staratelja, nadležna opštinska institucija je odgovorna za zaštitu deteta i pružanje odgovarajućeg alternativnog staranja ili trajnog pravnog staranja u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Samo kada mere podrške dostupne porodicama prema stavu (1) pokazuju da nisu dovoljne da sprečavaju nasilje, zapostavljanje, zanemarivanje, zlostavljanje, zloupotrebu i iskorišćavanje ili kada je dete u velikom neizbežnom riziku, institucije su odgovorne da intervenišu merama predviđenih ovim zakonom i važećem zakonodavstvu i da garantuju bezbednost i blagostanje deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 35 Individualna odgovornost</p> <p>Svako fizičko i pravno lice odgovorno je po odredbama ovog zakona kada je svojim</p>
--	--	--

<p>veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen e këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Edukimi dhe arsimimi</p> <p>1. Ndalohet privimi i fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim.</p> <p>2. Ministria përkatëse për arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar në gjitha nivelet e arsimit para universitar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.</p> <p>3. Në të gjitha nivelet e arsimit para universitar, fëmija mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, neglizhenca, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Fëmija mbrohet nga dhuna e shfaqur qoftë nga personeli arsimor, bashkëmoshatarët dhe nga secili person tjetër, brenda sistemit edukativo arsimor. Në procesin edukativ dhe arsimor,</p>	<p>present Law when, by his actions or omissions, he or she violates the Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Education</p> <p>1. It is prohibited to deprive a child of his/her right to education.</p> <p>2. The respective ministry of education should provide inclusive and equal access for all students in quality and free education on the basis of equal opportunities and non-discrimination, in accordance with age and ability to understand at all levels of pre-university education. This right shall also be granted to a child who is willing to continue education upon completing compulsory education.</p> <p>3. A child attending all forms of pre-university education shall be protected from all forms of physical and mental violence, abuse, maltreatment, exploitation, corporal punishment, negligence or any other form that puts at risk the life, safety, health, education and development of the child. The child shall be protected from violence exercised by the educational personnel, their peers and any other person within the educational system. During the educational</p>	<p>radnjama ili propustima izvršilo povredu ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Vaspitanje i obrazovanje</p> <p>1. Zabranjeno je lišenje deteta od prava na vaspitanje i obrazovanje.</p> <p>2. Odgovarajuće ministarstvo obrazovanja treba da obezbedi sveobuhvatan pristup i besplatno i kvalitetno pohađanje obrazovanja na osnovu jednakih mogućnosti i bez diskriminacije, u skladu sa njegovom starošću i sposobnošću razumevanja na svim nivoima preduniverzitetskog obrazovanja. Ovo pravo je garantovano i detetu koje želi nastaviti obrazovanje nakon završetka obaveznog obrazovanja.</p> <p>3. Na svim nivoima preduniverzitetskog obrazovanja dete je zaštićeno je od svih oblika fizičkog i mentalnog nasilja, zlostavljanja, iskorišćavanja, telesnog kažnjavanja, zanemarivanja ili bilo kojeg drugog oblika koji stavlja na rizik život, sigurnost, zdravlje, vaspitanje, obrazovanje i razvoj deteta. Dete je zaštićeno od nasilja koje se pojavljuje bilo od strane obrazovnog osoblja, vršnjaka i bilo koje druge osobe u vaspitno obrazovnom sistemu.</p>
--	---	---

<p>është e ndaluar të promovohet gjuha e urrejtjes, dhuna, jo toleranca, diskriminimi dhe format e tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore.</p> <p>4. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.</p> <p>5. Ministria përkatëse për arsim, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore nga pushteti lokal marrin masa konkrete, me qëllim që:</p> <p>5.1. të inkurajojë mësim-nxënien gjatë gjithë jetës, të zhvillojë respektin e fëmijës për identitetin kulturor, për gjuhën dhe vlerat kombëtare, respektin për kulturat e ndryshme si dhe respektin për ruajtjen e mjedisit;</p> <p>5.2. të mundësojnë qasjen e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por që kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;</p>	<p>process, it shall be forbidden to promote hate speech, violence, intolerance, or discrimination and other forms which incite human conflict.</p> <p>4. The parent or guardian shall take appropriate measures in order for the child to attend the compulsory education or other levels of education, according to the child's desires, and to ensure their regular and unobstructed attendance.</p> <p>5. The Ministry responsible for education, as the responsible public authority, and the local education units shall take concrete measures in order to:</p> <p>5.1. encourage lifelong learning, develop the child's respect for cultural identity, language and national values, respect for different cultures and environmental preservation;</p> <p>5.2. enable the child access to preschool education as well as compulsory free education for all children, even in cases where the children may have passed the age for compulsory education but have been unable to attend it;</p>	<p>U vaspitnom i obrazovnom procesu zabranjeno je promovisati govor mržnje, nasilje, netolerantnost, diskriminaciju i druge oblike koji podstiču međuljudske sukobe.</p> <p>4. Roditelj ili staratelj preduzima odgovarajuće mere da dete pohađa obavezno obrazovanje ili druge niveoe obrazovanja, prema želji deteta, i da garantuje njegovo redovno i neometano pohađanje.</p> <p>5. Relevantno Ministarstvo obrazovanja, kao odgovorni javni organ, kao i jedinice obrazovanja iz lokalne samouprave, preduzimaju konkretne mere kako bi:</p> <p>5.1. podsticali doživotno učenje, razvijali poštovanje deteta prema kulturnom identitetu, jeziku i nacionalnim vrednostima, poštovanje različitih kultura i poštovanje očuvanja životne sredine;</p> <p>5.2. omogućili pristup deteta predškolskom obrazovanju i besplatnom obaveznom obrazovanju za svu decu i u slučajevima kada su deca prekoračila starost obaveznog obrazovanja ali nisu bila u nemogućnosti pohađanja obrazovanja;</p>
---	--	---

<p>5.3. në bashkëpunim me institucionet relevante të zhvillojnë programe edukimi për prindër, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;</p> <p>5.4. të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrijnë nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim të parandalimit të barrierave për shkollimin e mëtejshëm të fëmijës;</p> <p>5.5. të identifikojnë dhe trajtojnë rastet e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën si dhe të ndërmarrin veprime konkrete sipas politikave nacionale për trajtimin e rasteve në nivel të shkollës dhe komunës.</p> <p>5.6. të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijë që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë shkollën apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;</p> <p>5.7. të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;</p>	<p>5.3. develop parental education programs, in cooperation with relevant institutions, including programs for preventing domestic violence;</p> <p>5.4. organize special lesson plans for a child who fails to reach the appropriate levels of the curriculum, in order to prevent the barriers to further education of the child;</p> <p>5.5. identify and address the cases of children at risk of dropping-out and undertake concrete actions according to national policies for dealing with cases at school and municipality level;</p> <p>5.6. organize special education learning plans for drop-out children, children who never attended school or returning from abroad, in order to integrate them into the national education system;</p> <p>5.7. monitor the child's right to rest, as well as the right to participate in cultural and artistic activities;</p>	<p>5.3. u saradnji sa relevantnim institucijama, razvijali programe obrazovanja za roditelje, uključujući programe za sprečavanje nasilja u porodici;</p> <p>5.4. organizovali posebne nastavne planove za dete koje ne uspeva da dostigne odgovarajuće nivoe nastavnog plana i programa, u cilju sprečavanja prepreka daljeg školovanja deteta;</p> <p>5.5. identifikovali i adresirali slučajeve djece u opasnosti od napuštanja škole kao i preduzimali konkretne radnje prema nacionalnim politikama za tretiranje slučajeva na nivou škole i opštine.</p> <p>5.6. organizovali posebne nastavne planove i programe za decu koja napuštaju školu ili koja nikada nisu pohađala školu ili za decu koja se vraćaju iz inostranstva radi njihove integracije u nacionalni sistem obrazovanja;</p> <p>5.7. nadgledali pravo deteta na opuštanje, kao i pravo na učešće u kulturnim i umetničkim aktivnostima;</p>
---	--	---

<p>5.8. të adresojnë parandalimin e përfshirjes të fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme, duke e trajtuar këtë tematikë me qasje kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare;</p> <p>5.9. sigurimi i mekanizmave efikasë për parandalim, trajtim brenda shkollës dhe raportim tek autoritetet përgjegjëse të rasteve të dhunës dhe dukurive të tjera negative;</p> <p>5.10. të zbatojnë sanksione përkatëse ligjore për personelin e institucioneve edukativo-arsimore, në rast kur ushtron, lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme në institucionet edukativo-arsimore, sipas këtij ligji;</p> <p>5.11. të sigurojnë mbrojtjen e fëmijës në internet, duke promovuar përdorimin e Teknologjisë Informative të Komunikimit, në mënyrë të dobishme dhe përgjegjshme;</p> <p>5.12. me anë të vetëdijesimit të adresohet parandalimi i trafikimit të fëmijëve, me qasje proaktive të trajtohet fëmija në rrezik për tu trafikuar;</p>	<p>5.8. address the prevention of child involvement in serious and dangerous labour, addressing this issue with curricular, cross-curricular and extracurricular approaches;</p> <p>5.9. provide effective mechanisms for prevention, treatment within the school and reporting situations of violence and other negative phenomena to responsible authorities;</p> <p>5.10. foresee and enforce appropriate sanctions for educational staff in cases where it exercises, allows, encourages, tolerates or does not report violent actions in educational institutions, according to this law;</p> <p>5.11. ensure child protection on the Internet, promoting the use of Information and Communications Technology in a useful and responsible manner;</p> <p>5.12. address the prevention of child trafficking by raising awareness, and treating children at risk of being trafficked with a proactive approach;</p>	<p>5.8. adresirali sprečavanje učešća dece u teškim i opasnim poslovima, tretirajući ovu temu kurikularnim, međukurikularnim i ekstrakurikularnim pristupom;</p> <p>5.9. obezbedili efikasne mehanizme za sprečavanje, tretiranje u školi i izveštavanje nadležnih organa slučajeva nasilja i drugih negativnih pojava;</p> <p>5.10. sprovodili odgovarajuće zakonske sankcije za osoblje vaspitno-obrazovnih institucija, u slučaju kada vrši, dozvoljava, podstiče, toleriše ili ne prijavljuje nasilne radnje u vaspitno-obrazovnim institucijama, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>5.11. obezbedili zaštitu deteta na Internetu, promovisanjem korišćenja informacione tehnologije na koristan i odgovoran način;</p> <p>5.12. kroz podizanje svesti adresirali sprečavanje trgovanja decom, proaktivnim pristupom tretirati dete u opasnosti od trgovanja;</p>
--	---	---

<p>5.13. në plan-programet mësimore të përfshijë module për mbrojtje nga rreziku i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në institucionet e arsimit para universitar dhe arsimit të lartë.</p> <p>6. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mos regjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës në kuadër të Qendrës për Punë Sociale ndërmerr masa të menjëhershme për regjistrimin e fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>7. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Ndalimi i ndëshkimit trupor</p> <p>1. Ndëshkimi trupor dhe masat disiplinore, të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjellje që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, janë të ndaluara në secilin ambient në shtëpi dhe familje, institucione edukativo arsimore, në institucionet e</p>	<p>5.13. include modules for protection against the risk of abuse and sexual exploitation in pre-university and higher education institutions curricula.</p> <p>6. In cases when a child not attending compulsory education, due to non-registration in the civil status offices or other reasons, are identified, the appropriate child protection officer within the Centre for Social Work shall take immediate measures to register the child at school, according to the legislation in force.</p> <p>7. During the educational process, the child is treated with dignity by the teachers and the staff, and is informed about his rights and means of exercising them, according to this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Prohibition of physical punishment</p> <p>1. Physical punishment and disciplinary measures that undermine and weaken the child's human dignity, including forms of physical and mental violence, as well as behaviors that degrade, disgrace and put the child into a difficult situation are prohibited in any environment at home and families, educational institutions, care institutions, law</p>	<p>5.13. u nastavnim planovima i programima uključili module za zaštitu od opasnosti zlostavljanja i seksualnog iskorišćavanja u preduniverzitetskim i visokoškolskim institucijama.</p> <p>6. U slučajevima kada se identifikuju deca koja ne pohađaju obavezno obrazovanje, zbog neregistracije u kancelarijama civilnog stanja ili iz drugih razloga, odgovarajući službenik za zaštitu deteta u okviru Centra za socijalni rad preuzima hitne mere za upis deteta u školi, prema važećem zakonodavstvu.</p> <p>7. Tokom nastavnog i vaspitnog procesa dete se dostojanstveno tretira od strane nastavnika i osoblja i obaveštava se o njegovim pravima i sredstvima njihovog ostvarivanja, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Zabrana telesnog kažnjavanja</p> <p>1. Telesno kažnjavanje i disciplinske mere koje oštećuju i slabe ljudsko dostojanstvo deteta, uključujući oblike fizičkog i mentalnog nasilja, kao i ponašanja koja degradiraju, osramote i dovode dete u lošu situaciju, zabranjene su u svakom kućnom i porodičnom okruženju, obrazovnim i vaspitnim institucijama, starateljskim</p>
--	---	---

<p>kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitetit.</p> <p>2. Është e ndaluar që një fëmijë të kthehet në subjekt të torturës dhe trajtimit jo njerëzor, jo dinjitoz, ndëshkimit trupor dhe trajtimit degradues nga secili person.</p> <p>3. Personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën nuk duhet të përdorin ndëshkimin trupor si mjet discipline dhe rregulli duhet të bazohet dhe ndërtohet mbi bazën e respektit dhe drejtësisë.</p> <p>4. Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Inspektorati i Arsimit merr masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi.</p> <p>5. Ministritë përkatëse sigurojnë nxjerrjen dhe krijimin e programeve të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe të hartojnë dhe krijojnë:</p> <p>5.1. Edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor;</p>	<p>enforcement and justice systems, working environments and community.</p> <p>2. It is prohibited for a child to be subjected to torture and non-human, non-dignified treatment, corporal punishment and degrading treatment by any person.</p> <p>3. Educational personnel and school related personnel should not use corporal punishment as a means of discipline and rule, but rather should work and build on the basis of respect and justice.</p> <p>4. The Municipal Directorate of Education and the Education Inspectorate shall take disciplinary measures against the educational personnel and reports the cases of corporal punishment of the child to the investigative bodies in accordance with the laws in force.</p> <p>5. The relevant ministries shall provide the issuance and establishment of awareness-raising programs regarding the harmful effects of corporal punishment and design and create:</p> <p>5.1. Education and awareness-raising regarding the degrading consequences of corporal punishment;</p>	<p>institucijama, organima reda i sistemu pravde, na radnom okruženju i u zajednici.</p> <p>2. Zabranjeno je da se dete pretvori u predmet mučenja i nečovečnog, nedostojanstvenog ophođenja, telesnog kažnjavanja i ponižavajućeg tretiranja od strane bilo koje osobe.</p> <p>3. Obrazovno osoblje i osoblje povezano sa školom ne smeju da koriste telesno kažnjavanje kao disciplinsko sredstvo i red se mora sprovesti i izgraditi na osnovu poštovanja i pravde.</p> <p>4. Opštinsko odeljenje za obrazovanje i prosvetna inspekcija preduzimaju disciplinske mere protiv nastavnog osoblja i izveštavaju istražne organe o slučajevima telesnog kažnjavanja deteta, u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>5. Relevantna ministarstva će obezbediti izdavanje i kreiranje programa podizanja svesti o štetnim efektima telesnog kažnjavanja i izrađuju i kreiraju:</p> <p>5.1. Obrazovanje i podizanje svesti u vezi sa štetnim posledicama telesnog kažnjavanja;</p>
--	--	--

<p>5.2. Programe prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në Institucione të Kujdesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Mbrojtja e të drejtës për privatësi</p> <p>1. Fëmijës i garantohet e drejta për privatësi, respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin dhe dinjitetin e fëmijës.</p> <p>2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, social e të shërbimeve. Privatësia përfshin të drejtën e fëmijës për të pasur opinionet, besimet dhe fenë e vet pa u ndikuar nga të tjerët, përfshirë prindërit dhe kujdestarët. Korrespondenca e shkruar dhe verbale e fëmijës, të dhënat e institucioneve edukativo arsimore, të dhënat mjekësore për fëmijën dhe statusin shëndetësor të tij duhet të mbeten konfidenciale, përveç nëse zbulimi i një informacioni të tillë është në interesin më të lartë të fëmijës dhe në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave.</p>	<p>5.2. Parenting programs that promote non-violent methods of disciplining in family and educational institutions.</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Protection of the right to privacy</p> <p>1. A child's right to privacy, respect of private, family life, housing, and correspondence is guaranteed and must be protected from malicious, arbitrary and unlawful interference affecting the morality and dignity of the child.</p> <p>2. The child's privacy is protected in all situations, including those within the family, healthcare, social and service institutions. Privacy includes the right of the child to have an opinion, beliefs and his/her religion without being influenced by others, including parents and guardians. Written and verbal correspondence of the child, educational institution data, medical data and records related to the health status of the child should remain confidential until the moment when this information is disclosed to the best interest of the child.</p>	<p>5.2. Programe roditeljstva, koji promovišu nenasilne načine discipline u porodici i vaspitno-obrazovnim institucijama i institucijama starateljstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 38 Zaštita prava na privatnost</p> <p>1. Detetu je garantovano pravo na privatnost, poštovanje privatnog, porodičnog života, stanovanje, korespondenciju i mora biti zaštićeno od zlonamernih, proizvoljnih i nezakonitih intervencija koje ugrožavaju moral i dostojanstvo deteta.</p> <p>2. Privatnost deteta je zaštićena u svim uslovima, uključujući one unutar porodice, institucija zdravstvene, socijalne zaštite, i sličnih institucija. Privatnost obuhvata pravo deteta da ima svoja mišljenja, verovanja i veroispovest bez uticaja drugih, uključujući roditelje i staratelje. Pismena i verbalna korespondencija deteta, podaci vaspitno-obrazovnih ustanova, zdravstveni podaci o detetu i njegov zdravstveni status moraju ostati poverljivi, osim ako je otkrivanje takvih informacija u najboljem interesu deteta i u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka.</p>
--	---	---

<p>3. Asnjë fëmijë nuk duhet të jetë subjekt i ndërhyrjeve të paligjshme ose arbitrare në jetën e tij private, në familje, në shtëpinë ose korrespondencën e tij, e as i cenimeve të nderit dhe reputacionit të tij.</p> <p>4. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.</p> <p>5. Veprimet e tilla dënohen sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>3. No child shall be subject to illegal or arbitrary intervention to his/her private, family life or correspondence, nor attacks to his/her reputation and dignity.</p> <p>4. A child's privacy shall be respected in all stages of court or administrative proceedings, including their publication in the media.</p> <p>5. Such actions are punishable under the legislation in force.</p>	<p>3. Nijedno dete ne sme biti predmet nezakonskih ili proizvoljnih intervencija u njegovom privatnom životu, porodici, kući ili korespondenciji, niti ugrožavanja njegove časti ili ugleda.</p> <p>4. Privatnost deteta se poštuje u svim fazama sudskih ili upravnih postupaka, uključujući njihovo objavljivanje u medijima.</p> <p>5. Takvi postupci su kažnjivi prema važećem zakonodavstvu.</p>
<p>Neni 39 Koha e lirë dhe loja</p>	<p>Article 39 Leisure and play</p>	<p>Član 39 Slobodno vreme i igra</p>
